“(1) Оценувањето на државните службеници се врши врз основа на податоци што се однесуваат на резултатите од нивната работа и личните квалитети што ги покажале во текот на работењето.”

#### Член 50

По членот 79 се додава нов член 79-а, кој гласи:

##### “Член 79-а

(1) Раководниот службеник кој го врши оценувањето е должен да го запознае непосредно претпоставениот раководен службеник, односно функционерот кој раководи со органот, за извршеното оценување.

(2) Органот од членот 3 став (2) на овој закон е должен да достави извештај за извршените оценувања до Агенцијата најдоцна еден месец по истекот на рокот од членот 77 став (1) на овој закон.

(3) Врз основа на извештајот од ставот (2) на овој член, Агенцијата може да побара од органот од членот 3 став (2) на овој закон повторно да го спроведе оценувањето за дел или за сите државни службеници, доколку оцени дека резултатите од оценувањето се неконзистентни, некомплетни, или дека постапката за оценување не е спроведена согласно со одредбите од овој закон.

(4) Содржината на извештајот од ставот (2) на овој член се утврдува со актот на Агенцијата од членот 78 став (6) на овој закон.”

#### Член 51

Членот 80 се менува и гласи:

“(1) Оцената за државниот службеник може да биде: “се истакнува”, “задоволува”, “делумно задоволува” и “не задоволува”.

(2) Државниот службеник кој не е задоволен со оцената од ставот (1) на овој член, може во рок од осум дена од денот на оценувањето да поднесе приговор до комисијата за преиспитување на оцената формирана од министерот, односно функционерот кој раководи со органот од членот 3 став (2) на овој закон.

(3) Комисијата од ставот (2) на овој член е составена од три члена, и тоа: секретарот, еден стручен државен службеник и еден државен службеник најмалку во истото звање кое го има државниот службеник кој го поднел приговорот на оценувањето.

(4) По исклучок, во органите од членот 3 став (2) на овој закон во кои нема секретар, член во комисијата е еден раководен државен службеник.

(5) Комисијата од ставот (2) на овој член, по спроведеното преиспитување на оцената, во рок од 30 дена донесува одлука против која државниот службеник има право на жалба до Агенцијата во рок од 15 дена од денот на нејзиното врачување.”

#### Член 52

Членот 81 се менува и гласи:

“На државниот службеник му престанува вработувањето:

- по спогодба;
- по негово барање;
- по сила на закон и
- во други случаи утврдени со овој закон.”

#### Член 53

По членот 81 се додаваат шест нови члена 81-а, 81-б, 81-в, 81-г, 81-д и 81-џ, кои гласат:

##### “Член 81-а

На државниот службеник му престанува вработувањето по спогодба, кога со секретарот, односно функционерот кој раководи со органот во кој не се именува секретар, ќе склучи писмена спогодба за престанок на вработувањето.

##### Член 81-б

(1) На државниот службеник му престанува вработувањето ако поднесе писмено барање за престанок на вработувањето.

(2) Во случај на престанок на вработувањето по барање на државниот службеник, отказниот рок трае 30 дена од денот на поднесувањето на барањето за престанок на вработувањето, освен ако државниот службеник и секретарот, односно функционерот кој раководи со органот во кој не се именува секретар поинаку не се спогодот.

##### Член 81-в

На државниот службеник му престанува вработувањето по сила на закон, ако:

- ја загуби работната способност - со денот на доставувањето на правосилното решение за утврдување на изгубената работна способност;
- му престане државјанството на Република Македонија - со денот на доставувањето на решението за отпуст од државјанство на Република Македонија;
- му е изречена казна забрана за вршење професија, дејност или должност - со денот на изрекувањето на казната;
- биде осуден за кривично дело во врска со службената должност или друго кривично дело кое го прави недостоен за државен службеник и за вршење на службата во органот од членот 3 став (2) на овој закон - со денот на врачувањето на правосилната пресуда;
- поради издржување на казна затвор во траење по долго од шест месеца - со денот на стапувањето на издржување на казната и
- исполнува услови за пензија согласно со закон.

## Член 81-г

На државниот службеник му престанува вработувањето и во случаите, ако:

- неоправдано отсуствува од работа најмалку три дена последователно во еден месец;
- биде оценет со оцена "не задоволува" два пати последователно или во последните пет години најмалку три пати;
- се утврди дека при вработувањето премолчил или дал невистинити податоци во однос на општите и посебните услови за вработување;
- во рок од 15 дена не се врати на работа по завршувањето на стручното оспособување или усовршување согласно со членот 24-а на овој закон и
- органот на државната управа, надлежен за инспекцијата на трудот, во рок од една година утврди дека државниот службеник е вработен спротивно на одредбите на овој закон.

## Член 81-д

(1) Решението за престанок на вработувањето на државниот службеник го донесува секретарот, односно функционерот кој раководи со органот во кој не се именува секретар.

(2) Решението за престанок на вработувањето се врачува лично на државниот службеник, по правило во работните простории на органот од членот 3 став (2) на овој закон во кој државниот службеник работи, односно на адреса на живеалиштето, односно престојувалиштето од кое државниот службеник секојдневно доаѓа на работа.

(3) Ако државниот службеник не може да се пронајде на адресата на живеалиштето, односно престојувалиштето или ако го одбие врачувањето, решението се објавува на огласната табла во органот од членот 3 став (2) на овој закон. По изминувањето на три работни дена се смета дека врачувањето е извршено.

## Член 81-ѓ

(1) Против решението за престанок на вработувањето државниот службеник има право на жалба до Агенцијата во рок од осум дена од денот на врачувањето на решението.

(2) Агенцијата одлучува по жалбата во рок од 15 дена од приемот на жалбата.

(3) Жалбата го одлага извршувањето на решението за престанок на вработувањето до донесувањето на конечното решение по жалбата."

## Член 54

По членот 82 се додава нова Глава VIII со четири нови члена 82-а, 82-б, 82-в и 82-г, кои гласат:

## "VIII ЗАШТИТА НА ПРАВАТА НА ДРЖАВНИТЕ СЛУЖБЕНИЦИ

## Член 82-а

(1) Државниот службеник на кој со решение на првостепен орган во органот од членот 3 став (2) на овој закон му е повредено правото од службенички однос, има право да поднесе жалба до Агенцијата во рок од 15 дена од денот на врачувањето на решението преку првостепениот орган, освен кога со овој закон поинаку не е утврдено.

(2) Првостепениот орган е должен жалбата, со пропратните списи, да ја достави до Агенцијата во рок од осум дена од денот на приемот на жалбата.

(3) По поднесената жалба од ставот (1) на овој член, Агенцијата одлучува во рок од 30 дена од денот на приемот на жалбата, освен кога со овој закон поинаку е утврдено.

(4) Агенцијата при одлучувањето по поднесената жалба од став (1) на овој член, може да ја отфрли жалбата како ненавремена, нецелосна или недозволена, да

ја одбие жалбата како неоснована и да го потврди првостепеното решение или да ја уважи жалбата и да го укине решението на првостепениот орган и предметот да го врати на повторно одлучување.

## Член 82-б

(1) Државниот службеник кој не е задоволен од конечната одлука донесена од Агенцијата во рокот утврден во членот 82-а од овој закон, има право во нареден рок од 15 дена да бара заштита на своите права пред надлежниот суд.

(2) Државниот службеник не може да бара заштита на правото пред надлежен суд, ако претходно не барал заштита на правото пред Агенцијата, односно пред комисијата од членот 82-г на овој закон, освен за правото на парично побарување.

## Член 82-в

Агенцијата со акт ги пропишува правилата на работење кога одлучува по жалба, односно приговор како второстепен орган.

## Член 82-г

Државните службеници вработени во Агенцијата, имаат право на жалба согласно со овој закон против решение со кое се одлучува за нивните права и обврски до надлежната второстепена Комисија на Владата на Република Македонија."

## Член 55

По Главата VIII се додава нова Глава IX и шест нови члена 82-д, 82-ѓ, 82-е, 82-ж, 82-з и 82-с, кои гласат:

## "IX РЕГИСТАР НА ДРЖАВНИ СЛУЖБЕНИЦИ

## Член 82-д

Агенцијата води Регистар на државни службеници (во натамошниот текст: Регистар), кој претставува единствена база на податоци за државните службеници.

## Член 82-ѓ

(1) Податоците што се внесуваат во Регистарот претставуваат класифицирани информации со степен на тајност определен согласно со закон.

(2) Како класифицирани информации со степен на тајност определен согласно со закон, во смисла на овој закон, се сметаат поединечните податоци за државните службеници, што се внесуваат во Регистарот.

## Член 82-е

(1) Органот од членот 3 став (2) на овој закон е должен секој податок за настаната промена во врска со државниот службеник да го достави до Агенцијата во рок од 15 дена, сметано од денот на настанатата промена.

(2) Агенцијата е должна податоците за државните службеници да ги внесе во Регистарот во рок од 15 дена од денот на нивното доставување.

(3) Агенцијата со правилник ги пропишува формата и содржината на обрасците за евидентирање на податоците за државните службеници.

## Член 82-ж

(1) Податоците од Регистарот можат да ги користат само државните службеници и органите од членот 3 став (2) на овој закон.

(2) Државниот службеник и органите од членот 3 став (2) на овој закон можат писмено да побараат извод од податоците кои се водат за нив во Регистарот.

(3) Органите од членот 3 ставови (2) и (3) на овој закон можат писмено да побараат збирни податоци и анализи за дел или за сите органи од членот 3 став (2) на овој закон, согласно со податоците кои се водат за нив во Регистарот.

(4) По исклучок од ставот (1) на овој член, збирни податоци и анализи можат писмено да побараат и да користат научни и други институции за научни и истражувачки цели.

(5) Врз основа на писменото барање од ставот (1) на овој член, Агенцијата доставува одговор во рок од еден месец, освен доколку обемот и комплексноста на барањето не го оправдува продолжувањето на рокот за одговор, но не подолго од уште еден месец.

(6) Агенцијата ги известува државниот службеник и органот од членот 3 став (2) на овој закон за продолжувањето на рокот за одговорот и причините за тоа.

#### Член 82-з

Агенцијата подготвува годишен извештај за податоците од Регистарот.

Годишниот извештај е јавен и се објавува најдоцна до крајот на првото тримесечје на наредната година за изминатата година.

Агенцијата донесува акт за содржината на извештајот од ставот (1) на овој член.

#### Член 82-с

Во случај на несовапаѓање на податоците внесени во Регистарот со податоците од пополнетиот образец, правно валидни се податоците од образецот.”

#### Член 56

Римскиот број “VIII” пред називот на Главата “ПРЕОДНИ И ЗАВРШНИ ОДРЕДБИ” се заменува со римскиот број “X”.

#### Член 57

Низ целиот текст на законот зборовите: “единиците на локалната самоуправа” се заменуваат со зборот “општините”, а зборовите: “службена тајна” се заменуваат со зборовите: “класифицирана информација со степен на тајност определен согласно со закон”.

#### Член 58

Подзаконските прописи чие донесување е утврдено со овој закон ќе се донесат во рок од шест месеца од денот на влегувањето во сила на овој закон.

#### Член 59

За секретар на градот Скопје, односно секретар на општина со седиште во град, односно секретар на општина со седиште во село, во рок од две години од денот на влегувањето во сила на овој закон, можат да се именуваат и лица кои не се вработени во администрацијата на градот Скопје и општинската администрација.

#### Член 60

Се овластува Законодавно-правната комисија на Собранието на Република Македонија да утврди прецизен текст на Законот за државните службеници.

#### Член 61

Овој закон влегува во сила со денот на објавувањето во “Службен весник на Република Македонија”.

## L I G J I PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT PËR NËPUNËSIT SHTETËRORË

### Neni 1

Në Ligjin për nëpunësit shtetërorë (“Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” numër 59/2000, 112/2000, 34/2001, 103/2001, 43/2002, 98/2002, 17/2003, 40/2003, 85/2003, 17/2004 dhe 69/2004), në nenin 1 pas fjalës: “nëpunësit” në rreshtin e tretë fjalët: “si dhe” fshihen, ndërsa pika në fund zëvendësohet me presje dhe shtohen fjalët: “si dhe kompetencat e Agjencisë për nëpunësit shtetërorë”.

### Neni 2

Në nenin 3 në paragrafin (2) fjalët: “organet e njërive të vetadministrimit lokal dhe të Qytetit të Shkupit” zëvendësohen me fjalët: “në administratën komunale dhe administratën e Qytetit të Shkupit”, ndërsa pas fjalëve: “Prokuroria publike” shtohen fjalët: “Komisioni Shtetëror Zgjedhor, Komisioni shtetëror për pengimin e korrupsionit, Drejtoria për mbrojtjen e të dhënave personale, Komisioni për mbrojtjen e konkurrencës”, ndërsa pika në fund fshihet dhe shtohen fjalët: (në tekstin e mëtejme: organet nga neni 3 paragrafi (2) i këtij ligji).

Paragrafi (3) ndryshon si vijon:

“(3) Dispozitat e këtij ligji zbatohen ndaj personave të punësuar në institucionet, të cilave u janë besuar autorizime publike dhe institucioneve që kryejnë veprimtari me interes publik, nëse kjo është përcaktuar me ligj.”

### Neni 3

Në nenin 6 në paragrafin (2) në alinenë e parë pas fjalëve: “sekretari i përgjithshëm” fjala “përkatësisht” fshihet, pikëpresja në fund zëvendësohet me presje dhe shtohen fjalët: “sekretari i Qytetit të Shkupit, sekretari i komunës me seli në qytet dhe sekretari i komunës me seli në fshat.”

Në paragrafin (5) fjalët: “Kuvendi i Republikës së Maqedonisë, kryetari i Republikës së Maqedonisë, Qeveria e Republikës së Maqedonisë”, fshihen, para fjalëve: “Prokuroria publike”, lidhëza “dhe” zëvendësohet me presje, ndërsa pas fjalëve: “Prokuroria publike” shtohen fjalët: “Komisioni Shtetëror Zgjedhor, Komisioni shtetëror për pengimin e korrupsionit, Komisioni për mbrojtjen e konkurrencës”, lidhëza “ndërsa” para fjalëve: “sekretari shtetëror” fshihet, pika në fund zëvendësohet me presje dhe shtohen fjalët: “edhe në Sekretariatit për çështje evropiane, sekretari i Qytetit të Shkupit emërohet në Qytetin e Shkupit, sekretari i komunës me seli në qytet emërohet në komunën me seli në qytet dhe sekretari i komunës me seli në fshat emërohet në komunën me seli në fshat.”

Paragrafi (6) fshihet.

Paragrafët (7) dhe (8), bëhen paragrafë (6) dhe (7).

Paragrafin (8) që bëhet paragraf (7) ndryshon si vijon:

“(7) Me propozim të Agjencisë për nëpunësit shtetërorë, Qeveria e Republikës së Maqedonisë me urdhëresë e rregullon përshkrimin e titujve të përcaktuar me këtë ligj.”

### Neni 4

Në nenin 7 paragrafi (2) ndryshon si vijon:

“(2) Agjencia i kryen punët si vijon:

- përgatit dhe miraton dispozita për nëpunësit shtetërorë për të cilët është e autorizuar me ligj, pas mendimit paraprak të organeve nga neni 3 paragrafi (2) të këtij ligji;

- jep pëlqim me shkrim për aktet e organizimit dhe sistematizimit të brendshëm të vendeve të punës së organeve nga neni 3 paragrafi (2) të këtij ligji;

- zhvillon politika dhe jep orientime lidhur me grupet e titujve dhe përshkrimin e vendeve të punës, zgjedhjen, punësimin dhe pushimin e punësimit, përfaqësimin adekuat dhe të drejtë, rrogat dhe kompensimet e rrogave, vlerësimin dhe përgjegjësinë disiplinore;

- vendos për ankesat dhe kundërshtimet si organ i shkallës së dytë;

- i koordinon aktivitetet që i dedikohen përkryerjes profesionale dhe trajnimit të nëpunësve shtetërorë;

- mban Regjistër të nëpunësve shtetërorë;

- grumbullon dhe përpunon të dhëna për pjesëtarët e punësuar të bashkësive në organet nga neni 3 paragrafi (2) të këtij ligji;

- e përcjell dhe kujdeset për zbatimin unik të ligjeve dhe dispozitave që u dedikohen nëpunësve shtetërorë dhe paralajmëron për moskonsekuencat në zbatimin e tyre të organet nga neni 3 paragrafi (2) të këtij ligji;

- e avancoon punën efikase dhe efektive të nëpunësve shtetërorë; dhe

- kryen punë të tjera të përcaktuara me ligj.”

Paragrafi (4) fshihet.

## Neni 5

Në nenin 8 në paragrafin (4) fjalët: “punën e vet” fshihen, ndërsa pas fjalës “për” shtohen fjalët: “punën e Agjencisë”.

## Neni 6

Pas nenit 8 shtohet nen i ri 8-a, si vijon:

## “Neni 8-a

Drejtori i Agjencisë:  
 - e përfaqëson Agjencinë;  
 - e organizon dhe siguron kryerjen e ligjshme dhe efikase të punëve dhe detyrave në Agjenci; dhe  
 - miraton dispozita dhe akte të tjera për të cilat është i autorizuar dhe ndërmerr masa të tjera nga kompetenca e Agjencisë në pajtim me ligjin.

Neni ekzistues 8-a bëhet neni 8-b.

## Neni 7

Në nenin 9 në paragrafin (1) pika 4) pas fjalës “përvojë” shtohen fjalët: “në profesion”.

Në pikën 5 fjalët: “masa e sigurisë” zëvendësohen me fjalën “dënim”.

Pas paragrafit (1) shtohet paragraf i ri (2) si vijon:

“(2) Plotësimi i kushtit të përgjithshëm nga paragrafi (1) pika 5 vërtetohet me aktin që e lëshon organi kompetent për udhëheqjen e evidencës ndëshkuese.”

Paragrafi (2) bëhet paragraf (3).

## Neni 8

Në nenin 10 në paragrafin (1) fjalët: “ato organe” zëvendësohen me fjalët: “organet nga neni 3 paragrafi (2) të këtij ligji”.

Paragrafi (2) fshihet.

Në paragrafin (3) që bëhet paragraf (2) pas fjalëve: “Enti shtetëror për revizion” shtohen fjalët: “Komisioni Shtetëror Zgjedhor, Komisioni shtetëror për pengimin e korrupsionit, Komisioni për mbrojtjen e konkurrencës”.

Në paragrafin (4), që bëhet paragraf (3) pas fjalës: “ministra” shtohen fjalët: “edhe në Sekretariatit për çështje evropiane”.

Në paragrafin (5) që bëhet paragraf (4) fjalët: “ministrat dhe nga organet e tjera të administratës shtetërore” zëvendësohen me fjalët: “organet nga neni 3 paragrafi (2) të këtij ligji”.

Pas paragrafit (4) shtohet paragraf i ri (5) si vijon:

“(5) Sekretarin e Qytetit të Shkupit, përkatësisht sekretarin e komunës me seli në qytet, përkatësisht sekretarin e komunës me seli në fshat, e emëron prefekti nga radhët e nëpunësve udhëheqës shtetërorë nga administrata e Qytetit të Shkupit, përkatësisht administrata komunale dhe mandati i tyre zgjat sa mandati i prefektit”.

## Neni 9

Neni 11 ndryshohet si vijon:

“(1) Kërkesën për nevojën e punësimeve të reja të nëpunësve shtetërorë, organet nga neni 3 paragrafi (2) të këtij ligji e dorëzojnë në Agjenci.

(2) Nëpunësit shtetërorë përveç sekretarëve të përgjithshëm, sekretarëve shtetërorë, sekretarit të Qytetit të Shkupit, sekretarëve të komunave me seli në qytet dhe sekretarëve të komunave me seli në fshat (në tekstin e mëtejshëm: sekretarët), punësohen përmes shpalljes publike që e shpall Agjencia, së paku në dy gazeta ditore, prej të cilave në së paku nga një prej gazetave që botohen në gjuhën maqedonishte dhe gazetave që botohen në gjuhën që e flasin së paku 20% nga qytetarët që flasin gjuhë zyrtare që dallon nga gjuha maqedonishte.

(3) Afati për paraqitjen në shpalljen publike nga paragrafi (2) të këtij neni nuk mund të jetë më i shkurtër se pesë ditë.

(4) Sekretari, si dhe funksionari i cili udhëheq me organin nga neni 3 paragrafi (2) dhe (3) të këtij ligji në të cilin nuk emërohet sekretar, formon Komision për zbatimin e procedurës për punësimin e nëpunësit shtetëror, të

përbërë nga tre anëtarë (në tekstin e mëtejshëm: Komisioni), me ç’rast pa u cenuar kriteret e përcaktuara me ligj, do të sigurohet përfaqësimi përkatës dhe i drejtë i qytetarëve që u takojnë të gjitha bashkësisve.

(5) Komisionin nga paragrafi (4) të këtij neni e përbëjnë një nëpunës udhëheqës shtetëror, një nëpunës profesional shtetëror nga organi nga neni 3 paragrafi (2) të këtij ligji dhe një anëtar i Agjencisë.

(6) Me përjashtim, në organet nga neni 3 paragrafi (2) të këtij ligji në të cilat nuk ka nëpunës shtetërorë udhëheqës, Komisionin e përbëjnë dy nëpunës shtetërorë ose dy të punësuar që nuk kanë statusin e nëpunësve shtetërorë nga organi nga neni 3 paragrafi (2) të këtij ligji dhe një anëtar i Agjencisë.”

## Neni 10

Neni 12 ndryshohet si vijon:

“(1) Kandidatët që janë paraqitur në shpalljen publike nga neni 11 paragrafi (2) të këtij ligji, përveç vendeve të punës me titull bashkëpunëtor më i ri dhe referent më i ri, të cilët i plotësojnë kushtet, e japin edhe provimin profesional. Provimi profesional jepet në Agjenci.

(2) Agjencia përgatit listën prej më së shumti pesë kandidatësh më të suksesshëm për secilin vend pune, që e kanë dhënë provimin profesional, të cilën e dorëzon te Komisioni nga neni 11 paragrafi (4) të këtij ligji.

(3) Me përjashtim, lista nga paragrafi (2) të këtij neni, zgjerohet me kandidatët që i kanë rezultatet si kandidati i fundit të listës.

(4) Kandidatët nga paragrafi (2) dhe (3) të këtij neni, në Agjencinë për nëpunës shtetërorë paraqesin dëshmi për plotësimin e kushteve nga neni 9 të këtij ligji.

(5) Nëse kandidati, i cili është në listë nga paragrafi (2) dhe (3) të këtij neni nuk dëshmon se i plotëson kushtet nga neni 9 të këtij ligji, atëherë në vendin e tij vjen kandidati vijues nga lista.

(6) Komisioni nga neni 11 paragrafi (4) të këtij ligji bën intervistë me kandidatët nga paragrafi (2) dhe (3) të këtij neni dhe e përpilon listën e radhitjes. Lista e përgatitur e radhitjes i dorëzohet sekretarit, përkatësisht funksionarit që udhëheq me organin nga neni 3 paragrafi (2) të këtij ligji në të cilin nuk emërohet sekretar, i cili e bën zgjedhjen e kandidatit.

(7) Kundër vendimit nga paragrafi (6) të këtij neni, kandidati që nuk është zgjedhur ka të drejtë ankese në Agjenci në afat prej tetë ditësh nga dita kur është njoftuar me shkrim për zgjedhjen e kryer. Agjencia vendos për ankesën në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të ankesës.

(8) Ankesa e prolongon zbatimin e vendimit nga paragrafi (6) të këtij neni.

(9) Pas mbarimit të procedurës për zgjedhje, sekretari, përkatësisht funksionari që udhëheq me organin nga neni 3 paragrafi (2) të këtij ligji në të cilin nuk emërohet sekretar, merr aktvendim për punësim.”

## Neni 11

Në nenin 12-a fjalët: “punësim dhe përzgjedhje” zëvendësohen me fjalët: “përzgjedhje dhe punësim”.

## Neni 12

Në nenin 13 paragrafi (1) numri “(3)” zëvendësohet me numrin “(4)”.

Paragrafi (2) shlyhet.

## Neni 13

Neni 15 ndryshon si vijon:

“(1) Provimin profesional e organizon dhe realizon Agjencia.

(2) Provimin e praktikantit e organizon Agjencia, ndërsa zbatohet në organin nga neni 3 paragrafi (2) të këtij ligji, ku punësohet nëpunësi shtetëror.

(3) Provimi profesional përbëhet nga pjesa e përgjithshme, e veçantë dhe praktike. Për pjesën e

përgjithshme dhe praktike të dhënë të provimit profesional, Agjencia lëshon vërtetim që vlen dy vjet nga dita e lëshimit të tij.

(4) Mënyrën, procedurën dhe kriteret për zbatimin e provimit profesional dhe të praktikantit, i përcakton Agjencia.”

(5) Programin për dhënie e provimit profesional dhe të praktikantit e miraton Agjencia për nëpunësit shtetërorë.”

#### Neni 14

Neni 16 ndryshon si vijon:

“Nëpunësi shtetëror, me pëlqimin e tij, mund të punësohet pa shpallje publike, nga njëri organ në tjetrin nga neni 3 paragrafi (2) të këtij ligji, nëse për këtë pajtohen sekretarët, përkatësisht funksionarët që udhëheqin me organet në të cilat nuk emërohet sekretari, pas pajtimit paraprak të Agjencisë.”

#### Neni 15

Në nenin 19 në paragrafin (1) fjalët: “ministrit, përkatësisht” dhe fjala “shtetëror” fshihen.

Në paragrafin (3) pas fjalëve: “menjëherë për këtë” shtohen fjalët: “me shkrim”, fjala “shtetëror” fshihet, ndërsa pika në fund fshihet dhe shtohen fjalët: “edhe Komisioni shtetëror për pengimin e korrupsionit.”

Në paragrafin (4) pas fjalës “eporri” në rreshtin e dytë dhe të fundit fjala “shtetëror”, fshihet.

Pas paragrafit (4) shtohet paragrafi i ri (5), si vijon:

“(5) Nëpunësi shtetëror nuk mund të merret në përgjegjësi për shkak të paralajmërimit të dhënë nga paragrafi (3) të këtij neni”.

#### Neni 16

Pas nenit 22 shtohet nen i ri 22-a, si vijon:

##### “Neni 22-a

(1) Nëpunësi shtetëror, sipas nevojës së organit ose me kërkesën e tij, mund të sistemohet në organin e njëjtë në vend tjetër pune, me të njëjtin titull, në pajtim me aktin e sistematizimit të vendeve të punës.

(2) Personi nga neni 3 paragrafi (5) i këtij ligji pa statusin e nëpunësit shtetëror, sipas nevojës së organit ose me kërkesën e tij, mund të sistemohet në organin e njëjtë në vend tjetër pune me titullin përkatës dhe të fitojë statusin e nëpunësit shtetëror, pas pajtimit paraprak të Agjencisë dhe provimit të dhënë profesional.”

#### Neni 17

Neni 24 ndryshohet si vijon:

“(1) Nëpunësi shtetëror ka të drejtë dhe obligim që të afësohet dhe perfeksionohet profesionalisht në pajtim me nevojat e organit ku është punësuar.

(2) Agjencia me akt e përcakton sistemin e koordinimit të aftësimi dhe perfeksionimit profesional të nëpunësve shtetërorë.

(3) Aftësimi dhe perfeksionimi profesional zbatohet në bazë të programit vjetor të miratuar në vitin në vijim për vitin e ardhshëm.

(4) Programin nga paragrafi (3) të këtij neni e miraton organi nga neni 3 paragrafi (2) të këtij ligji pas mendimit të marrë paraprak nga Agjencia.

(5) Për nevojat nga paragrafi (1) të këtij neni, sigurohen mjete në Buxhetin e Republikës së Maqedonisë dhe buxhetin e komunës dhe Qytetit të Shkupit.”

#### Neni 18

Pas nenit 24, shtohet nen i ri 24-a, si vijon:

##### “Neni 24-a

(1) Të drejtat dhe obligimet e ndërsjella të organit nga neni 3 paragrafi (2) të këtij ligji dhe nëpunësit shtetëror që është dërguar në aftësimin dhe perfeksionimin profesional sipas nevojës së organit, rregullohen me marrëveshje.

(2) Nëpunësi shtetëror, me kërkesën e tij, e me pajtimin e organit, ka të drejtë për leje të papagueshme në kohëzgjatje prej më së shumti dy vjetësh, për shkak të aftësimi dhe perfeksionimit profesional, që nuk financohet nga organi.

(3) Nëpunësi shtetëror obligohet që në afat prej 15 ditësh pas mbarimit të lejes së papagueshme nga paragrafi (2) të këtij neni, të kthehet në punë dhe të sistemohet në vendin e punës që i përgjigjet titullit, që e ka pasur para dërgimit për aftësim dhe perfeksionim profesional.

(4) Gjatë kohës së lejes së papagueshme nga paragrafi (2) të këtij neni, nëpunësit shtetëror i pezullohen të drejtat e punësimit.”

#### Neni 19

Pas nenit 29 shtohen neni i ri 29-a, si vijon:

##### “Neni 29-a

Në rast pengese për ardhje në punë nëpunësi shtetëror obligohet që ta njoftojë nëpunësin përgjegjës të drejtpërdrejtë, përkatësisht sekretarin, përkatësisht funksionarin që udhëheq me organin nga neni 3 paragrafi (2) të këtij ligji, në të cilin nuk emërohet sekretari, në afat prej 24 orësh nga momenti i pengesës. Nëse kjo është e pamundur të bëhet për shkaqe objektive ose të forcës madhore, në këtë rast njoftimin obligohet ta bëjë menjëherë pas ndërprerjes së shkakut që e ka pamundësuar njoftimin.”

#### Neni 20

Në nenin 31 paragrafi (1), fjalët: “Ministri, përkatësisht funksionari që udhëheq me organin nga neni 3 paragrafi (2) të këtij ligji” zëvendësohen me fjalët: “Sekretari, përkatësisht funksionari që udhëheq me organin nga neni 3 paragrafi (2) të këtij ligji në të cilin nuk emërohet sekretari”.

#### Neni 21

Pas nenit 31 shtohen dy nene të reja 31-a dhe 31-b si vijojnë:

##### “Neni 31-a

Nëpunësi shtetëror që është zgjedhur ose emëruar në funksion shtetëror ose publik, të përcaktuar me ligj, e ushtrimi i të cilit kërkon që përkohësisht të pushojë t'i kryejë punët dhe detyrat e punës të nëpunësit shtetëror, ka të drejtë që në afat prej 15 ditësh pas pushimit të ushtrimit të funksionit, të kthehet në organin nga neni 3 paragrafi (2) i këtij ligji, prej nga ka shkuar për ushtrimin e funksionit, në vendin e punës që i përgjigjet shkallës së tij të përgatitjes profesionale.

##### Neni 31-b

Nëpunësi shtetëror që është dërguar në punë jashtë vendit në kuadër të bashkëpunimit ndërkombëtar–teknik ose kulturor–arsimor dhe shkencor, në përfaqësitë diplomatike dhe konsullore, ka të drejtë që në afat prej 15 ditësh nga dita e pushimit të punës jashtë vendit, të kthehet në punë në organin nga neni 3 paragrafi (2) i këtij ligji, prej nga ka shkuar jashtë vendit, në vendin e punës që i përgjigjet shkallës së tij të përgatitjes profesionale. Gjatë kohës së mungesës nga puna, nëpunësit shtetëror i pezullohen të drejtat e punësimit.

Nëpunësit shtetëror bashkëshort i të cilit është dërguar në punë jashtë vendit në kuadër të bashkëpunimit ndërkombëtar–teknik ose kulturor–arsimor dhe shkencor, në përfaqësitë diplomatike dhe konsullore, me kërkesën e tij i pezullohen të drejtat nga punësimi dhe ka të drejtë që në afat prej 30 ditësh nga dita e pushimit të punës së bashkëshortit jashtë vendit, të kthehet në organin nga neni 3 paragrafi (2) i këtij ligji, prej nga ka shkuar jashtë vendit, në vendin e punës që i përgjigjet shkallës së tij të përgatitjes profesionale.”

#### Neni 22

Në nenin 32 paragrafi (1) ndryshon si vijon:

“(1) Pas skadimit të mandatit ose pas shkarkimit, sekretari sistemohet në organin e njëjtë ose punësohet pa

shpallje publike në organ tjetër nga neni 3 paragrafi (2) të këtij ligji, në vendin e punës në njërin nga titujt e grupit të nëpunësve udhëheqës shtetërorë, por jo më poshtë se titulli që e ka pasur para se të emërohet si sekretar.”

Në paragrafët (2) dhe (3) fjalët: “sekretari i përgjithshëm, përkatësisht shtetëror” zëvendësohen me fjalën “sekretari”.

#### Neni 23

Në nenin 33 paragrafi (2) pika në fund zëvendësohet me presje dhe shtohen fjalët: “në buxhetin e komunës dhe në buxhetin e Qytetit të Shkupit.”

#### Neni 24

Në nenin 36 në paragrafin (2) në tabelë, pas rreshtit të tretë shtohen tre rreshta të rinj, si vijojnë:

“I	sekretari i Qytetit të Shkupit	615
I	sekretari i komunës me seli në qytet	550
I	sekretari i komunës me seli në fshat	460”

#### Neni 25

Në nenin 37 në paragrafin (3) numri “40” zëvendësohet me numrin “39”.

#### Neni 26

Në nenin 38 në paragrafin (1) fjalët: “sekretarit i përgjithshëm, përkatësisht shtetëror” zëvendësohen me fjalën: “sekretarit”.

Në paragrafin (2), pas fjalëve: “neni 3” shtohen fjalët: “paragrafi (2)”.

#### Neni 27

Neni 40 ndryshohet si vijon:

“Nëpunësit shtetëror që ka marrë titullin më të lartë, i paguhet rroga bazë, sipas nenit 35 të këtij ligji dhe shtesa e rrogës për titullin më të lartë që e ka marrë sipas nenit 36 të këtij ligji.”

#### Neni 28

Në nenin 41, në paragrafin (2), lidhëza “dhe” pas fjalëve: “rroga bazë” zëvendësohet me presje, ndërsa fjalët: “që përkon me vendin e punës që ai e ka zënë para avancimit” zëvendësohen me fjalët: “edhe shtesa e rrogës për karrierë për një shkallë më të ulët nga shkalla që e ka fituar para se të vlerësohet me notën “nuk kënaq”, përveç në rast kur nëpunësi shtetëror sistemohet në vendin e punës me titull më të ulët sipas nenit 31 të këtij ligji.”

#### Neni 29

Neni 43 ndryshon si vijon:

“Vlera e pikës për rrogën e të punësuarve në administratën komunale, përkatësisht administratën e Qytetit të Shkupit, për çdo vit përcaktohet me vendim për realizimin e buxhetit të komunës dhe buxhetit të Qytetit të Shkupit.”

#### Neni 30

Neni 44 ndryshon si vijon:

“Të punësuarit nga neni 3 paragrafi (3) të këtij ligji, në institucionet të cilave u janë besuar autorizime publike dhe institucionet që kryejnë veprimtari me interes publik, do të marrin rrogë sipas dispozitave të këtij ligji.”

#### Neni 31

Në nenin 52, në paragrafin (2), në alinenë pesë, numri “2” në kllapa zëvendësohet me numrin “2,5”.

Në paragrafin (3) pika në fund zëvendësohet me presje dhe shtohen fjalët: “me vendimin për realizimin e buxhetit të komunës dhe buxhetit të Qytetit të Shkupit”.

Paragrafi (5) fshihet.

#### Neni 32

Në nenin 64 në paragrafin (1), fjalët “sekretari i përgjithshëm, përkatësisht shtetëror”, zëvendësohet me fjalën “sekretari”.

#### Neni 33

Në nenin 66, në paragrafi (1), në pikën 2) lidhëza “dhe” në fund të fjalisë zëvendësohet me pikëpresje dhe shtohet pika e re 3, si vijon:

“3) sistemimi në vendin e punës me titull më të ulët në kohëzgjatje prej gjashtë muajsh deri në një vit dhe”.

Pika 3 bëhet pikë 4.

Pas paragrafit (1), shtohet paragrafi i ri (2) si vijon:

“(2) Gjatë shqiptimit të masave disiplinore nga paragrafi (1) të këtij neni merren parasysh pesha e cenimit të detyrës zyrtare, pasojat nga ky cenim, shkalla e përgjegjësisë së nëpunësit shtetëror, rrethanat në të cilat është shkaktuar cenimi, sjellja e tij e mëparshme dhe kryerja e punëve, si dhe rrethanat e tjera lehtësuese dhe rënduese.”

#### Neni 34

Në nenin 67 në paragrafin (1), lidhëza “dhe” në fund të pikës 3 dhe pika në fund të pikës 4 zëvendësohen me pikëpresje.

Në paragrafin (1) pas pikës 4, shtohen dy pika të reja 5 dhe 6 si vijojnë:

“5) mosnjohimi i paarsyeshëm i nëpunësit epror të drejtpërdrejtë, përkatësisht funksionarit që udhëheq me organin nga neni 3 paragrafi (2) të këtij ligji, për pengesën për mosardhje në punë në afat prej 24 orësh, dhe

6) refuzimi i aftësisht dhe perfeksionimit profesional në të cilin dërgohet nëpunësi shtetëror.”

Në paragrafin (2), pika në fund fshihet dhe shtohen fjalët: “në kohëzgjatje prej një deri në tre muaj”.

#### Neni 35

Në nenin 68, në paragrafin (1) në pikën 5 fjalët: “nëpunësi shtetëror epror i drejtpërdrejtë” zëvendësohen me fjalët: “ministri, përkatësisht funksionari që udhëheq me organin nga neni 3 paragrafi (2) i këtij neni, përkatësisht nëpunësi udhëheqës”.

Në paragrafin (1) pas pikës 10 lidhëza “dhe” fshihet, ndërsa pika 11 zëvendësohet, si vijon:

“11) keqpërdorimi i statusit ose tejkallim i autorizimeve në kryerjen e detyrave zyrtare”.

Pas pikës 11 shtohen gjashtë pika të reja 12, 13, 14, 15, 16 dhe 17, si vijojnë:

“12) keqpërdorimi i pushimit mjekësor;

13) dhënia e informatës së klasifikuar me shkallë sekretit të përcaktuar sipas ligjit;

14) futja, përdorimi dhe puna në ndikimin e alkoolit ose mjeteve narkotike;

15) mosrespektimi i dispozitave për mbrojtje nga sëmundja, mbrojtje në punë, nga zjarri, shpërthimi, veprimi i dëmshëm i helmeve dhe materieve të tjera të rrezikshme dhe cenimi i dispozitave për mbrojtjen e mjedisit jetësor;

16) vënia e interesit financiar personal në konflikt me pozitën dhe statusin e nëpunësit shtetëror, dhe

17) sjellja ofenduese ose e dhunshme.”

Paragrafi (2) ndryshon si vijon:

“(2) Për shkelje disiplinore nga paragrafi (1) i këtij neni shqiptohet:

- dënim me para prej 10% deri 30% nga shuma njëmuajore e rrogës së paguar të nëpunësit shtetëror në muajin para kryerjes së shkeljes disiplinore, në kohëzgjatje prej një deri në gjashtë muaj;

- sistemimi në vendin e punës me titull më të ulët, në kohëzgjatje prej gjashtë muajsh deri në një vit, pas skadimit të së cilës nëpunësi shtetëror kthehet në vendin e punës me titullin me të cilin ka qenë i sistemuar para shqiptimit të masës disiplinore, dhe

- pushimi i punësimit, nëse kanë ndodhur pasoja të dëmshme për organin, kurse me këtë rast nuk janë konfirmuar rrethana lehtësuese për nëpunësin shtetëror që e ka bërë shkeljen.”

Paragrafi (3) fshihet.

#### Neni 36

Pas nenit 68, shtohet nen i ri 68-a si vijon:

## "Neni 68-a

Shuma e përgjithshme e ndëshkimeve në para të shqiptuara nëpunësit shtetëror gjatë një muaji për parregullsi disiplinore dhe shkelje disiplinore, nuk mund ta tejkalojë 30% e shumës së rrogës së tij të përgjithshme për atë muaj."

## Neni 37

Në nenin 69, në paragrafin (1) fjalët "ministri, përkatësisht funksionari, i cili udhëheq me organin nga neni 3 i këtij ligji", zëvendësohen me fjalët "sekretari, përkatësisht funksionari, i cili udhëheq me organin në të cilin nuk emërohet sekretar".

Pas paragrafit (1) shtohet paragraf i ri (2), si vijon:

"(2) Me përjashtim, në organet nga neni 3 paragrafi (2) të këtij ligji, në të cilat nuk ka nëpunës shtetërorë udhëheqës, raportin me shkrim e paraqet nëpunësi udhëheqës apo funksionari, i cili udhëheq me organin."

Paragrafi (2) bëhet paragraf (3).

## Neni 38

Neni 70 ndryshohet si vijon:

"(1) Sekretari, përkatësisht funksionari, i cili udhëheq me organin nga neni 3 paragrafi (2) të këtij ligji në të cilin nuk emërohet sekretar, formon Komisionin për udhëheqjen e procedurës disiplinore për shkeljen disiplinore (në tekstin e mëtejme: Komisioni), në afat prej tetë ditësh nga dita e paraqitjes së propozimit për ngritjen e procedurës disiplinore.

(2) Komisioni nga paragrafi (1) të këtij neni përbëhet prej tre anëtarësh, edhe atë një nëpunësi shtetëror udhëheqës, një nëpunësi shtetëror me titull nga grupi i njëjtë i titujve, si dhe nëpunësi shtetëror kundër të cilit zhvillohet procedura disiplinore dhe një anëtar i Agjencisë. Anëtarët e Komisionit kanë zëvendës.

(3) Me përjashtim, në organet nga neni 3 paragrafi (2) të këtij ligji, në të cilët nuk ka nëpunës shtetërorë udhëheqës, Komisionin nga paragrafi (1) të këtij neni e përbëjnë dy nëpunës shtetërorë nga organi dhe një anëtar të Agjencisë.

(4) Komisioni nga paragrafi (1) të këtij neni, pas procedurës së zbatuar disiplinore i propozon masë përkatëse disiplinore sekretarit, përkatësisht funksionarit, i cili udhëheq me organin nga neni 3 paragrafi (2) të këtij ligji në të cilin nuk emërohet sekretar.

(5) Nëse Komisioni nga paragrafi (1) i këtij neni, vërteton se nëpunësi shtetëror nuk është përgjegjës, apo nuk janë plotësuar kushtet për marrjen e aktvendimit për shqiptimin e masës disiplinore, i propozon sekretarit, përkatësisht funksionarit i cili udhëheq me organin nga neni 3 paragrafi (2) të këtij ligji në të cilin nuk emërohet sekretar, që ta hedhë poshtë propozimin, përkatësisht ta ndërpresë procedurën.

(6) Sekretari, përkatësisht funksionari, i cili udhëheq me organin nga neni 3 paragrafi (2) të këtij ligji në të cilin nuk emërohet sekretar, në bazë të propozimit të Komisionit, merr aktvendim për shqiptimin e masës disiplinore, përkatësisht për hedhjen poshtë të propozimit, përkatësisht për ndërprerjen e procedurës.

(7) Aktvendimi për shqiptimin e masës disiplinore i dorëzohet personalisht nëpunësit shtetëror, me të drejtë në lokalet punuese të organit nga neni 3 paragrafi (2) në të cilin nëpunësi shtetëror punon, përkatësisht në adresën e vendbanimit, përkatësisht vendqëndrimin prej nga nëpunësi shtetëror çdo ditë vjen në punë.

(8) Nëse nëpunësi shtetëror nuk mund të gjendet në adresën e vendbanimit, përkatësisht vendqëndrimin apo nëse e refuzon dorëzimin, aktvendimi shpallet në tabelën e shpalljeve në organin nga neni 3 paragrafi (2) të këtij ligji. Pas kalimit të tri ditësh pune nga dita e shpalljes në tabelën e shpalljeve llogaritet se dorëzimi është kryer.

(9) Procedura disiplinore mbaron në afat prej 60 ditësh, duke llogaritur nga dita e marrjes së aktvendimit për formimin e Komisionit nga paragrafi (1) të këtij neni."

## Neni 39

Neni 71 ndryshon si vijon:

"(1) Çdo nëpunës shtetëror dhe person tjetër, në pajtim me ligjin, ka të drejtë të parashtrijë iniciativë për ngritjen e procedurës disiplinore kundër nëpunësit shtetëror që duhet të jetë e arsyetuar.

(2) Propozim për ngritjen e procedurës disiplinore kundër nëpunësit shtetëror paraqet në mënyrë të drejtpërdrejtë nëpunësi shtetëror epror, përkatësisht nëpunësi udhëheqës apo funksionari që udhëheq me organin nga neni 3 paragrafi (2) të këtij ligji në të cilin nuk emërohet sekretar.

(3) Propozimi nga paragrafi (2) të këtij neni dërgohet te nëpunësi shtetëror dhe organizata sindikale, ku është anëtar nëpunësi shtetëror, në organin nga neni 3 paragrafi (2) i këtij ligji."

## Neni 40

Pas nenit 71 shtohen katër nene të reja 71-a, 71-b, 71-v dhe 71-g, si vijojnë:

## "Neni 71-a

Procedura disiplinore nuk mund të ngrihet nëse ka kaluar një muaj nga dita kur në mënyrë të drejtpërdrejtë nëpunësi shtetëror udhëheqës, përkatësisht nëpunësi udhëheqës apo funksionari, i cili udhëheq me organin nga neni 3 paragrafi (2) të këtij ligji në të cilin nuk emërohet sekretar, ka kuptuar për shkeljen e detyrës zyrtare.

## Neni 71-b

Procedura disiplinore nuk mund të ngrihet nëse kanë kaluar tre muaj nga dita kur është bërë shkelja e detyrës zyrtare.

## Neni 71-v

Me përjashtim, për procedurën disiplinore të ngritur sipas ekspertizës së revizionit të brendshëm, zbatohen afatet nga neni 74-b dhe 74-v të këtij ligji.

## Neni 71-g

Nëse shkelja e detyrës zyrtare tërheq edhe përgjegjësi penale, procedura disiplinore për përcaktimin e përgjegjësisë së nëpunësit shtetëror parashkruhet në afat prej 2 vjetësh nga dita kur kuptohet për shkeljen."

## Neni 41

Në nenin 72 pas fjalëve: "në mënyrë të drejtpërdrejtë nëpunësi shtetëror udhëheqës", shtohen fjalët: "përkatësisht nëpunësi shtetëror apo funksionari, i cili udhëheq me organin nga neni 3 paragrafi (2) të këtij ligji në të cilin nuk emërohet sekretar".

Pas paragrafit (1) shtohen dy paragrafë të rinj (2) dhe (3), si vijojnë:

"(2) Nëpunësi shtetëror mund të suspendohet nga organi sipas nenit 3 paragrafi (2) të këtij ligji, në rastet kur kundër tij është ngritur procedurë penale për veprë penale të bërë në punë apo në lidhje me punën, apo është ngritur procedurë disiplinore për shkelje disiplinore, ndërsa shkelja është e asaj natyre që prania e tij e mëtejme në organin derisa zgjat procedura do të shprehet në dëm të shërbimit, përkatësisht do ta pengojë apo pamundësojë përcaktimin e përgjegjësisë për shkelje disiplinore.

(3) Suspendimi nga paragrafi (2) të këtij neni zgjat deri në marrjen e aktvendimit të plotfuqishëm."

## Neni 42

Në nenin 73 numri "(4)" zëvendësohet me numrin "(6)".

## Neni 43

Pas nenit 73 shtohet nen i ri 73-a, si vijon:

## "Neni 73-a

Agjencia, me akt, në mënyrë më të përafërt përcakton mënyrën e udhëheqjes së procedurës disiplinore për përcaktimin e shkeljes disiplinore."

## Neni 44

Në nenin 74, paragrafi (2) ndryshon, si vijon:

“(2) Funkcionari, i cili udhëheq me organin nga neni 3 paragrafi (2) i këtij ligji, formon Komision për përcaktimin e përgjegjësive materiale të nëpunësit shtetëror.”

Paragrafi (3) zëvendësohet me tre paragrafë të rinj (3), (4) dhe (5), si vijojnë:

“(3) Komisioni nga paragrafi (2) të këtij neni përbëhet prej tre anëtarësh dhe atë një nëpunësi udhëheqës shtetëror, një nëpunësi shtetëror me titull nga grupi i njëjtë i titujve, si dhe nëpunësi shtetëror kundër të cilit zhvillohet procedurë për përcaktimin e përgjegjësive materiale dhe një anëtar të Agjencisë. Anëtarët e Komisionit kanë zëvendës.

(4) Komisioni nga paragrafi (2) i këtij neni përcakton përgjegjësive materiale për ekzistimin e dëmit të bërë material, lartësinë e tij dhe mënyrën e krijimit, kush e ka shkaktuar dëmin dhe kush do ta kompensojë.

(5) Komisioni nga paragrafi (2) të këtij neni, për gjendjen e përcaktuar faktike paraqet raport, në bazë të së cilit funksionari, i cili udhëheq me organin nga neni 3 paragrafi (2) të këtij ligji merr aktvendim për kompensimin e dëmit.”

## Neni 45

Pas nenit 74 shtohen shtatë nene të reja: 74-a, 74-b, 74-v, 74-g, 74-d 74-gj dhe 74-e, si vijojnë:

## “Neni 74-a

Propozim për ngritjen e procedurës për përcaktimin e përgjegjësive materiale kundër nëpunësit shtetëror parashtron në mënyrë të drejtpërdrejtë nëpunësi shtetëror epror, përkatësisht nëpunësi udhëheqës apo funksionari që udhëheq me organin nga neni 3 paragrafi (2) të këtij ligji në të cilin nuk emërohet sekretar.

## Neni 74-b

Procedura për përcaktimin e përgjegjësive materiale nuk mund të ngrihet, nëse kanë kaluar 60 ditë nga dita kur në mënyrë të drejtpërdrejtë nëpunësi shtetëror epror, përkatësisht nëpunësi udhëheqës apo funksionari, i cili udhëheq me organin nga neni 3 paragrafi (2) të këtij ligji në të cilin nuk emërohet sekretar, ka kuptuar për të.

## Neni 74-v

Procedura për përcaktimin e përgjegjësive materiale nuk mund të ngrihet, nëse nga dita kur është kryer dëmi material ka kaluar një vit.

## Neni 74-g

Procedura për përcaktimin e përgjegjësive materiale nuk mund të zhvillohet më gjatë se 60 ditë, duke llogaritur nga dita e marrjes së aktvendimit për formimin e Komisionit nga neni 74 paragrafi (2) të këtij ligji.

## Neni 74-d

Kundër aktvendimit nga neni 74, paragrafi (5) të këtij ligji, nëpunësi shtetëror ka të drejtë të paraqesë ankesë në Agjenci, në afat prej tetë ditësh nga dita e dorëzimit të aktvendimit.

## Neni 74-gj

Nëse nëpunësi shtetëror, në afat prej tre muajsh nga aktvendimi definitiv për kompensim të dëmit, nuk e kompenzon dëmin, organi nga neni 3 paragrafi (2) të këtij ligji, ngre procedurë para gjykatës kompetente.

## Neni 74 -e

Nëse nëpunësi shtetëror pëson dëm në punë, apo në lidhje me punën, organi nga neni 3 paragrafi (2) të këtij ligji është i obliguar t'ia kompensojë dëmin në pajtim me dispozitat e Ligjit për marrëdhënie obliguese.”

## Neni 46

Në nenin 75 dhe 76, pas numrit "3", shtohen fjalët: “paragrafi (2)”.

## Neni 47

Në nenin 77 në paragrafin (1) fjalët: “sekretari i përgjithshëm, përkatësisht sekretari shtetëror” zëvendësohen me fjalën: „sekretari”.

Në paragrafin (2) pas fjalëve në ndërtesën shtohen fjalët: "si dhe nëpunësit shtetërorë, të cilët për herë të parë janë punësuar në organet nga neni 3 paragrafi (2) të këtij ligji, në vitin për të cilin bëhet vlerësimi dhe kanë punuar më pak se gjashtë muaj”.

## Neni 48

Neni 78 ndryshohet si vijon:

“(1) Vlerësimin e nëpunësve shtetërorë e kryen në mënyrë të drejtpërdrejtë nëpunësi udhëheqës shtetëror epror.

(2) Me përjashtim, në organet nga neni 3 paragrafi (2) të këtij ligji, në të cilat nuk ka nëpunës shtetërorë udhëheqës, vlerësimin e kryen në mënyrë të drejtpërdrejtë nëpunësi më i lartë udhëheqës apo funksionari, i cili udhëheq me organin.”

(3) Vlerësimin e nëpunësve shtetërorë, të cilët gjatë vitit janë punësuar në organ tjetër nga neni 3 paragrafi (2) të këtij ligji, në bazë të nenit 16 të këtij ligji, apo janë sistemuar në vend tjetër pune në organ, e kryen nëpunësi i ri epror udhëheqës i drejtpërdrejtë, në bazë të raportit me shkrim nga nëpunësi i mëparshëm epror udhëheqës i drejtpërdrejtë.

(4) Nëse drejtpërdrejt nëpunësi udhëheqës epror gjatë vitit e ndërton vendin e punës, apo në rast se i ndërpritet punësimi, vlerësimin e nëpunësve shtetërorë me të cilët ka udhëhequr, e kryen drejtpërdrejt nëpunësi i ri udhëheqës epror, në bazë të raportit me shkrim që e përgatit në mënyrë të obligueshme nëpunësi i mëparshëm udhëheqës epror i drejtpërdrejtë.

(5) Përmbajtja e raporteve nga paragrafët (3) dhe (4) të këtij neni përcaktohet me aktin e Agjencisë nga paragrafi (6) i këtij ligji.

(6) Mënyra dhe procedura për vlerësimin e nëpunësve shtetërorë përcaktohet me aktin e Agjencisë.”

## Neni 49

Në nenin 79 paragrafi (1) ndryshon, si vijon:

“(1) Vlerësimi i nëpunësve shtetërorë bëhet në bazë të të dhënave që u dedikohen rezultateve të punës së tyre dhe cilësive personale që i kanë treguar gjatë punës.”

## Neni 50

Pas nenit 79 shtohet nen i ri 79-a, si vijon:

## “Neni 79-a

(1) Nëpunësi udhëheqës, i cili bën vlerësimin është i obliguar që ta njoftojë nëpunësin udhëheqës epror të drejtpërdrejtë, përkatësisht funksionarin, i cili udhëheq me organin, për vlerësimin e kryer.

(2) Organi nga neni 3 paragrafi (2) të këtij ligji është i obliguar të dërgojë raport për vlerësimet e kryera në Agjencinë më së voni një muaj pas skadimit të afatit nga neni 77 paragrafi (1) të këtij ligji.

(3) Në bazë të raportit nga paragrafi (2) të këtij neni, Agjencia mund të kërkojë nga organi nga neni 3 paragrafi (2) të këtij ligji që përsëri ta zbatojë vlerësimin për një pjesë, apo për të gjithë nëpunësit shtetërorë, nëse vlerëson se rezultatet e vlerësimit janë jo konzistente, jo complete, apo procedura e vlerësimit nuk është zbatuar në pajtim me dispozitat e këtij ligji.

(5) Përmbajtja e raportit nga paragrafi (2) të këtij neni përcaktohet me aktin e Agjencisë nga neni 78 paragrafi (6) i këtij ligji.”

## Neni 51

Neni 80 ndryshon, si vijon:

“(1) Vlerësimi për nëpunësin shtetëror mund të jetë: “dalohet”, “kënaq”, “pjesërisht kënaq” dhe “nuk kënaq”.

(2) Nëpunësi shtetëror, i cili nuk është i kënaqur me vlerësimin nga paragrafi (1) të këtij neni, në afat prej tetë

ditësh nga dita e vlerësimit, mund të paraqesë kundërshtim në Komisionin për rivlerësimin e vlerësimit, të formuar nga ministri, përkatësisht funksionari, i cili udhëheq me organin nga neni 3 paragrafi (2) të këtij ligji.

(3) Komisioni nga paragrafi (2) të këtij neni përbëhet prej tre anëtarësh, edhe atë: sekretarit, një nëpunësi profesional shtetëror dhe një nëpunësi shtetëror së paku me titull të njëjtë që e ka nëpunësi shtetëror i cili ka paraqitur kundërshtim për vlerësimin.

(4) Me përjashtim, në organet nga neni 3 paragrafi (2) në të cilat nuk ka sekretar, anëtari në Komision është një nëpunës udhëheqës shtetëror.

(5) Komisioni nga paragrafi (2) të këtij neni, pas rivlerësimit të zbatuar, në afat prej 30 ditësh merr vendim kundër të cilit nëpunësi shtetëror ka të drejtë ankese në Agjencinë në afat prej 15 ditësh nga dita e dorëzimit të tij."

#### Neni 52

Neni 81 ndryshon si vijon:

"Nëpunësit shtetëror i pushon punësimi:

- me marrëveshje;
- me kërkesën e tij;
- me fuqinë e ligjit, dhe
- në raste tjera të caktuara me këtë ligj."

#### Neni 53

Pas nenit 81 shtohen gjashtë nene të reja: 81-a, 81-b, 81-v, 81-g, 81-d dhe 81-gj, si vijojnë:

#### "Neni 81-a

Nëpunësit shtetëror i pushon punësimi me marrëveshje, kur sekretari, përkatësisht funksionari i cili udhëheq me organin në të cilin nuk emërohet sekretar, do të lidhë marrëveshje me shkrim për pushimin e punësimit.

#### Neni 81-b

(1) Nëpunësit shtetëror i pushon punësimi nëse paraqet kërkesë me shkrim për pushimin e punësimit.

(2) Në rast të pushimit të punësimit me kërkesën e nëpunësit shtetëror, afati i pushimit nga puna zgjat 30 ditë nga dita e paraqitjes së kërkesës për pushimin e punësimit, përveç nëse nëpunësi shtetëror dhe sekretari, përkatësisht funksionari i cili udhëheq me organin në të cilin nuk emërohet sekretar, nuk merren vesh ndryshe.

#### Neni 81-v

Nëpunësit shtetëror i pushon punësimi me fuqinë e ligjit, nëse:

- e humb aftësinë e punës - me ditën e dërgimit të aktvendimit të plotfuqishëm për përcaktimin e aftësisë së humbur të punës;
- i pushon shtetësia në Republikën e Maqedonisë - me ditën e dërgimit të aktvendimit për shkarkimin nga shtetësia e Republikës së Maqedonisë;
- i është shqiptuar dënim ndalim për kryerjen e profesionit, veprimtarisë apo obligimit - me ditën e shqiptimit të dënimit;
(2) Iniciativa qytetare mund të ngrihet për parashtrimin e propozimit për qasje për ndryshimin e Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), propozim për nxjerrjen e ligjit dhe për shpalljen e referendumeve në nivel shtetëror (në tekstin e mëtejme: iniciativa qytetare në nivel shtetëror).

(3) Iniciativa qytetare mund të ngrihet edhe për nxjerrjen rregullës së caktuar të komunave, të Qytetit të Shkupit dhe të komunave në Qytetin e Shkupit; për zgjidhjen e çështjeve të caktuara me kompetencë të këshillave të komunave, Qytetit të Shkupit dhe komunave

në Qytetin e Shkupit, dhe shpalljen e referendumeve në nivel lokal (në tekstin e mëtejme: iniciativa qytetare në nivel lokal).

## Neni 4

Tubimi i qytetarëve është formë e deklarimit të drejtpërdrejtë të qytetarëve për vendosjen e çështjeve me rëndësi lokale për komunat, Qytetin e Shkupit dhe komunat në Qytetin e Shkupi, dhe me rëndësi për vetadministrimin vendor të cilës i dedikohet çështja.

## Neni 5

Për veprimet, aktet, parashtrimet dhe shkresat tjera për zbatimin e referendumeve dhe formave tjera të deklarimit të drejtpërdrejtë të qytetarëve, nuk paguhet taksë dhe të gjitha veprimet në procedurë lirohen nga pagesa e të gjitha llojeve të tatimit.

## II. REFERENDUMI

## Neni 6

(1) Referendumi mund të shpallet për mbarë territorin e Republikës së Maqedonisë (në tekstin e mëtejme: referendum në nivel shtetëror).

(2) Referendumi mund të shpallet edhe për rajonin e komunës, Qytetin e Shkupit dhe komunat në Qytetin e Shkupit (në tekstin e mëtejme: referendum në nivel lokal).

## Neni 7

(1) Në referendum qytetarët deklarohen në mënyrë të drejtpërdrejtë me votim të fshehtë.

(2) Të drejtë votimi në referendum kanë qytetarët që kanë të drejtë zgjedhore dhe janë të regjistruar në Listën zgjedhore (në tekstin e mëtejme: qytetarët).

(3) Askush nuk mund të thirret në përgjegjësi për votim, përkatësisht në mosvotim në referendum.

## Neni 8

(1) Referendumi shpallet për arsye të vendosjes së qytetarëve ose për konsultimin e qytetarëve.

(2) Vendimi i marrë në referendumin për vendosje është i obligueshëm.

(3) Vendimi i marrë në referendum për konsultime nuk është i obligueshëm.

## Neni 9

Referendumi shpallet me vendim në të cilin janë përfshirë:

- organi që e ka shpallur referendumin;
- territori apo rajoni për të cilin shpallet referendum;
- emri i dispozitës, përkatësisht pyetja apo pyetjet për të cilat vendosin qytetarët në referendum;
- arsyetimi i dispozitës, përkatësisht pyetjes apo pyetjeve për të cilat shpallet referendum;
- pyetja e referendumeve apo pyetjet, përkatësisht një apo më shumë propozime normash për të cilat vendosin qytetarët;
- dita e mbajtjes së referendumeve; dhe
- lloji i referendumeve.

## Neni 10

(1) Për ditë të mbajtjes së referendumeve caktohet dita e diel.

(2) Në ditën e njëjtë (të dielën) mund të mbahen dy apo më shumë referendume.

(3) Qytetarët për mbajtjen e referendumeve lajmërohen përmes thirrjes publike.

## Neni 11

(1) Referendumi zbatohet në vendvotimet e caktuara me ligj.

(2) Më së voni pesë ditë para mbajtjes së referendumeve, komisionet zgjedhore komunale në mënyrë publike i shpallin vendvotimet për zbatimin e votimit të referendumeve.

## Neni 12

- (1) Për referendumin propozuesi i autorizuar mund të udhëheqë propagandë publike me shpenzimet e veta.  
 (2) Propaganda publike për referendumin doemos duhet të mbarojë më së voni 48 orë para ditës së votimit.

## Neni 13

- (1) Votimi i referendumit fillon prej orës 7,00 dhe zgjat pandërprerë deri më ora 19,00.  
 (2) Vendvotimi mbyllet në orën 19,00, ndërsa qytetarëve që gjenden në objektin për votim, u mundësohet të votojnë.  
 (3) Vendvotimi në të cilin kanë votuar të gjithë qytetarët të regjistruar në ekstraktin e Listës zgjedhore, mund të mbyllet edhe para skadimit të afatit nga paragrafi (1) i këtij neni.

## Neni 14

Në vendvotim vendoset vendimi për shpalljen e referendumit, emri i rregullës për të cilën vendoset në referendum, përkatësisht emri i pyetjes apo pyetjeve për të cilat qytetarët do të vendosin në referendum.

## Neni 15

- (1) Në referendum votohet me fletëvotim.  
 (2) Fletëvotimi përmban pyetjen që vendoset në referendum, udhëzimin për mënyrën e votimit dhe numrin serik të fletëvotimit në pjesën që mbetet në kërcellin e bllokut.  
 (3) Nëse votohet për më shumë pyetje, për çdo pyetje votohet në fletëvotim të veçantë.  
 (4) Pyetja në fletëvotim doemos duhet të jetë e formuluar në mënyrë precize dhe jo e dykuptimtë, kështu që qytetari në referendum të mund të përgjigjet me "PËR" apo "KUNDËR".

## Neni 16

- (1) Fletëvotimi për referendumin në nivel shtetëror botohet në gjuhën maqedonishte dhe në alfabetin e saj cirilik.  
 (2) Në komunat dhe në Qytetin e Shkupit në të cilat krahas gjuhës maqedonishte dhe alfabetit të saj cirilik në përdorim zyrtar është edhe gjuha tjetër zyrtare dhe alfabeti i saj, fletëvotimi botohet në gjuhën maqedonishte dhe në alfabetin e saj cirilik, dhe në gjuhën zyrtare dhe në alfabetin që është në përdorim zyrtar në atë komunë dhe në Qytetin e Shkupit.

## Neni 17

- (1) Fletëvotimi i referendumit në nivel lokal botohet në gjuhën maqedonishte dhe në alfabetin e saj cirilik.  
 (2) Në komunat, Qyteti i Shkupit dhe komunat në Qytetin e Shkupit në të cilat krahas gjuhës maqedonishte dhe alfabetit të saj cirilik në përdorim zyrtar është edhe gjuha tjetër zyrtare dhe alfabeti i saj, fletëvotimi botohet në gjuhën maqedonishte dhe në alfabetin e saj cirilik, dhe në gjuhën zyrtare dhe alfabetin që është në përdorim zyrtar në atë komunë, në Qytetin e Shkupit dhe në komunat në qytetin e Shkupit.

## Neni 18

Qytetari në referendum deklarohet ashtu që në fletëvotim e rrethon fjalën "PËR" apo "KUNDËR".

## Neni 19

Referendumi për çështje të njëjtë nuk mund të përsëritet para skadimit të afatit prej dy vitesh nga dita e referendumit të mbajtur.

## 1. Referendumi në nivel shtetëror

## Neni 20

(1) Referendumin në nivel shtetëror e shpall Kuvendi i Republikës së Maqedonisë (në tekstin e mëtejme: Kuvendi).

(2) Kuvendi shpall referendum në nivel shtetëror me iniciativën personale dhe me propozimin e së paku 150.000 qytetarëve.

## Neni 21

- (1) Propozimi për shpalljen e referendumit në nivel shtetëror me arsyetim i parashtrohet kryetarit të Kuvendit të Republikës së Maqedonisë (në tekstin e mëtejme: kryetari i Kuvendit).  
 (2) Kuvendi është i obliguar që në afat prej 30 ditësh nga parashtrimi i propozimit nga paragrafi (1) i këtij neni, të marrë vendim për shpalljen e referendumit.

## Neni 22

- (1) Vendimi për shpalljen e referendumit në nivel shtetëror shpallet në "Gazetën zyrtare të Republikës së Maqedonisë" dhe në mjetet tjera të informim publik.  
 (2) Nga dita e shpalljes së vendimit për shpalljen e referendumit në nivel shtetëror në "Gazetën zyrtare të Republikës së Maqedonisë" deri në ditën e mbajtjes, nuk mund të kalojnë më pak se 60 dhe më shumë se 90 ditë.

## Neni 23

Referendumi në nivel shtetëror në mënyrë të obligueshme shpallet për marrjen e vendimit të Kuvendit për ndërrimin e kufirit të Republikës së Maqedonisë dhe vendimit për hyrje ose dalje nga lidhja apo bashkësia me shtete të tjera.

## Neni 24

Referendumi në nivel shtetëror mund të shpallet edhe për nevojën e ratifikimeve të marrëveshjeve ndërkombëtare dhe për çështje të tjera me kompetencë të Kuvendit (referendumi paraprak) dhe për vendime të marra nga Kuvendi apo për deklarimin e qytetarëve për çështje të tjera për të cilat ka vendosur Kuvendi (referendum plotësues).

## Neni 25

Referendum në nivel shtetëror mund të shpallet për çështje që duhet të rregullohen me ligj (referendum paraprak) ose për rivlerësim të ligjit që është nxjerrë paraprakisht (referendum plotësues).

## Neni 26

- (1) Referendum paraprak mund të shpallet për:  
 - çështje të caktuar që duhet të rregullohet me ligj;  
 - rregullimin e çështjes së caktuar që nuk është rregulluar me ligj.  
 (2) Referendumi plotësues mund të shpallet për rivlerësim të ligjit që është nxjerrë paraprakisht.

## Neni 27

Për konsultime paraprake të qytetarëve për çështje me rëndësi më të gjerë për Republikën e Maqedonisë, mund të shpallet referendum në nivel shtetëror për konsultimin e qytetarëve (referendum për konsultim).

## Neni 28

- (1) Referendumi në nivel shtetëror nuk mund të shpallet për çështje që kanë të bëjnë me Buxhetin e Republikës së Maqedonisë dhe llogarinë përfundimtare të Buxhetit; për dhëniet publike; për rezervat e Republikës së Maqedonisë; për çështjet e zgjedhjeve, emërimeve dhe shkarkimeve dhe për amnistinë.  
 (2) Referendumi në nivel shtetëror nuk mund të shpallet për çështje që kanë të bëjnë me mbrojtjen, gjendjen luftarake dhe të jashtëzakonshme dhe për rregullat me plotfuqishmëri ligjore të nxjerra gjatë kohës së luftës apo gjendjes së jashtëzakonshme.  
 (3) Referendumi në nivel shtetëror nuk mund të shpallet për çështje për të cilat Kuvendi vendos me shumicë votash nga deputetët e pranishëm me ç'rast doemos duhet të ketë shumicë votash nga deputetët e pranishëm që u takojnë bashkësive që nuk janë shumicë në Republikën e Maqedonisë.

## Neni 29

(1) Vendimi për ndërrimin e kufirit të Republikës së Maqedonisë dhe vendimi për hyrje apo dalje nga lidhja apo bashkësia me shtete të tjera, janë marrë në referendum nëse në referendum për to kanë votuar shumica nga numri i përgjithshëm i qytetarëve të regjistruar në Listën zgjedhore.

(2) Vendimi nga paragrafi (1) i këtij neni i marrë në referendum është i obligueshëm.

## Neni 30

(1) Vendimet e referendumit në nivel shtetëror llogariten të miratuara nëse për to kanë votuar shumica e numrit të përgjithshëm të qytetarëve që kanë votuar, nëse kanë votuar më shumë se gjysma nga numri i përgjithshëm i qytetarëve të regjistruar në Listën zgjedhore, përveç në rastet kur për çështje të veçanta me Kushtetutën dhe me këtë ligj nuk është përcaktuar ndryshe.

(2) Kuvendi është i obliguar që në afat prej 60 ditësh pas shpalljes së rezultateve nga referendumit, ta rregullojë çështjen, përkatësisht ligjin sipas të cilit është vendosur në referendum, në pajtim me rezultatet e referendumit.

## 2. Organet për zbatimin e referendumit në nivel shtetëror

## Neni 31

Organet për zbatimin e referendumit në nivel shtetëror, janë:

- Komisioni Zgjedhor Shtetëror;
- komisionet zgjedhore komunale për zbatimin e zgjedhjeve për deputetë në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë (komisionet zgjedhore komunale); dhe
- këshillat zgjedhore.

## Neni 32

- (1) Komisioni Zgjedhor Shtetëror:
- kujdeset për përgatitje ligjore dhe zbatimin e referendumit në nivel shtetëror;
  - emëron kryetar, anëtarë dhe zëvendës të tyre në komisionet zgjedhore komunale;
  - ndërmerr përgatitje teknike për zbatimin e referendumit në nivel shtetëror;
  - përcakton formularët për zbatimin e referendumit në nivel shtetëror dhe i shpall në "Gazetën zyrtare të Republikës së Maqedonisë";
  - përcakton formën, madhësinë, ngjyrën dhe numrat serikë të fletëvotimeve;
  - i dorëzon dhe i pranon materialet votuese të komisioneve zgjedhore komunale dhe nga komisionet zgjedhore komunale;
  - përcakton standarde unike për materialin votues;
  - i informon qytetarët për mënyrën dhe teknikën e votimit dhe për mënyrën e realizimit të së drejtës zgjedhore;
  - siguron kushte materiale për zbatimin e referendumit në nivel shtetëror;
  - përcakton mënyrën e dorëzimit dhe të ruajtjes së materialit votues;
  - organizon shtypjen e materialit votues;
  - i parashtron raport Kuvendit për referendumin e zbatuar në nivel të shtetëror në afat prej tri ditësh nga dita e mbajtjes së tij;
  - miraton Rregullore dhe Udhëzim për kompensimin e organeve për zbatimin e referendumit në nivel shtetëror dhe i parashtron raport financiar Kuvendit;
  - përcakton llojin e mjetit me të cilin shënohen dhe kontrollohen personat të cilët kanë votuar ( llambë UV, sprej dhe jastëk grafiti);
  - formon trupa ndihmës për kryerjen e punëve organizative- teknike;
  - shpall në shtypin ditor përshkrimet e vendeve zgjedhore;

- kryen punët e përcaktuara me Ligjin për listën zgjedhore për zbatimin e referendumit në nivel shtetëror;
- vendos sipas kundërshtimeve;
- përcakton dhe shpall rezultatin e referendumit në nivel shtetëror; dhe
- kryen edhe punët e tjera të caktuara me ligj.

(2) Puna e Komisionit Zgjedhor Shtetëror është publike.

## Neni 33

Komisioni Zgjedhor Komunal:

- kujdeset për zbatimin ligjor të referendumit në nivel shtetëror;
- e emëron përbërjen e këshillave zgjedhore dhe jep udhëzime për punën e tyre;
- bën edukimin e anëtarëve të këshillave zgjedhore;
- ndërmerr përgatitje teknike për zbatimin e referendumit në nivel shtetëror sipas udhëzimeve dhe instruksioneve të Komisionit Zgjedhor Shtetëror;
- i informon qytetarët për mënyrën dhe teknikën e votimit;
- i dorëzon dhe pranon materialet votuese të këshillave zgjedhore dhe nga këshillat zgjedhore;
- i grumbullon rezultatet e votimit nëpër vendvotime;
- e dorëzon materialin e votimit në Komisionin Zgjedhor Shtetëror në afat prej tri orësh pas pranimit të materialit të votimit nga këshilli zgjedhor; dhe
- kryejnë edhe punët e tjera të përcaktuara me ligj.

## Neni 34

- (1) Këshilli Zgjedhor formohet për secilin vendvotim.
- (2) Këshilli Zgjedhor përbëhet nga kryetari, dy anëtarë dhe zëvendësit e tyre.
- (3) Këshillat zgjedhore formohen më së voni 20 ditë para ditës së paraparë për mbajtjen e referendumit në nivel shtetëror.

## Neni 35

- Këshilli Zgjedhor:
- në mënyrë të drejtpërdrejtë udhëheq me votimin në vendvotim;
  - siguron rregullshmëri dhe fshehtësi në votim;
  - siguron mbajtjen e lirë dhe të qetë të votimit;
  - i grumbullon rezultatet e votimit në vendvotim;
  - e dorëzon materialin e votimit në Komisionin Zgjedhor Komunal në afat prej tri orësh pas mbarimit të votimit; dhe
  - kryen edhe punët e tjera të përcaktuara me ligj.

## 3. Referendumi në nivel lokal

## Neni 36

(1) Referendum në nivel lokal shpall këshilli i komunës, i Qytetit të Shkupit dhe komunave në Qytetin e Shkupit (në tekstin e mëtejme: Këshilli), me iniciativën personale dhe me propozimin e së paku 20 % të qytetarëve të komunës, Qytetit të Shkupit dhe komunave në Qytetin Shkupit.

(2) Këshilli mund të shpallë referendum në nivel lokal për çështje me kompetencë të tij për të cilat me ligj është i autorizuar të vendosë.

## Neni 37

(1) Vendimi për shpalljen e referendumit në nivel lokal shpallet në fletoren zyrtare të komunës, të Qytetit të Shkupit dhe të komunave në Qytetin e Shkupit dhe përmes mjeteve për informim publik në mënyrë të caktuar me statut.

(2) Nga dita e shpalljes së vendimit për shpalljen e referendumit në Fletën zyrtare të komunës, të Qytetit të Shkupit dhe të komunave në qytetin e Shkupit deri në ditën e mbajtjes së referendumit në nivel lokal, nuk mund të kalojnë më pak se 25 as më shumë se 40 ditë.

## Neni 38

Referendumi në nivel lokal mund të shpallet për nxjerrje të rregullës, për çështje që duhet të rregullohen në komunë, në Qytetin e Shkupit dhe komunat në Qytetin e Shkupit (referendum paraprak) apo për rivlerësim të rregullës që është nxjerrë paraprakisht (referendum plotësues).

## Neni 39

(1) Referendumi paraprak në nivel lokal mund të shpallet për:

- çështje të caktuar që duhet të rregullohet me dispozitë;
- rregullimin e çështjes së caktuar që nuk është rregulluar me dispozitë.

(2) Referendumi plotësues mund të shpallet për rivlerësimin e rregullës që është nxjerrë paraprakisht.

## Neni 40

(1) Referendumi në nivel lokal nuk mund të shpallet për çështje që kanë të bëjnë me buxhetin dhe llogarinë përfundimtare të buxhetit të komunës, Qytetit të Shkupit dhe komunave në Qytetin e Shkupit dhe për organizimin e administratës së komunës.

(2) Referendumi në nivel lokal nuk mund të shpallet për çështje për të cilat këshilli vendos me shumicë votash nga anëtarët pranishëm të këshillit krahas, me ç'rast doemos duhet të ketë shumicë votash nga anëtarët e pranishëm të Këshillit që u takojnë bashkësive që nuk janë popullsi shumicë në komunë, në Qytetin e Shkupit dhe në komunat e Qytetit të Shkupit.

## Neni 41

(1) Vendimet e referendumit në nivel lokal llogariten si të marra nëse për to kanë votuar shumica e numrit të përgjithshëm të qytetarëve që kanë votuar, nëse kanë votuar më shumë se gjysma nga numri i përgjithshëm i qytetarëve të regjistruar në ekstraktin e Listës zgjedhore për komunën, Qytetin e Shkupit dhe komunat në Qytetin e Shkupit ku zbatohet referendumi.

(2) Këshilli i komunës, i Qytetit të Shkupit dhe komunave në Qytetin e Shkupit, është i obliguar që në afat prej 60 ditësh pas shpalljes së rezultateve të referendumit, ta rregullojë çështjen sipas të cilës është vendosur në referendum në pajtim me rezultatet e referendumit.

#### 4. Organet për zbatimin e referendumit në nivel lokal

## Neni 42

Organet për zbatimin e referendumit në nivel lokal, janë:

- komisionet zgjedhore komunale dhe Komisioni Zgjedhor i Qytetit të Shkupit për zbatimin e zgjedhjeve lokale (komisioni zgjedhor); dhe
- këshillat zgjedhore.

## Neni 43

(1) Komisioni zgjedhor:

- kujdeset për përgatitje ligjore dhe zbatimin e referendumit në nivel lokal;
- i emëron kryetarin, anëtarët dhe zëvendësit e tyre të këshillave zgjedhore;
- harmonizon punën dhe u jep udhëzime këshillave zgjedhore;
- ndërmerr përgatitje teknike për zbatimin e referendumit në nivel lokal;
- i përcakton formularët për zbatimin e referendumit në nivel lokal dhe i shpall në fletoren zyrtare të komunës, Qytetit të Shkupit dhe komunave në Qytetin e Shkupit;
- përcakton formën, madhësinë, ngjyrën dhe numrat serik të fletëvotimeve;
- i dorëzon dhe i pranon materialet votuese të këshillave zgjedhore dhe nga këshillat zgjedhore;
- përcakton standardet e vetme për materialin votues;

- i informon qytetarët për mënyrën dhe teknikën e votimit dhe për realizimin e të drejtës zgjedhore;

- përcakton mënyrën e ruajtjes dhe përdorimit të materialit votues;

- organizon botimin e materialit votues;

- përcakton kompensimin e organeve për zbatimin e referendumit në nivel lokal dhe i parashtron raport financiar Këshillit për referendumin e zbatuar në nivel lokal;

- përcakton dhe shpall rezultatit e referendumit në nivel lokal, në afat prej dy ditësh nga dita e mbajtjes së tij;

- vendos sipas kundërshtimeve; dhe

- kryen edhe punë të tjera të përcaktuara me ligj.

(2) Puna e Komisionit Zgjedhor është publike.

## Neni 44

(1) Këshillat zgjedhore formohen më së voni pesë ditë para ditës së paraparë për mbajtjen e referendumit në nivel lokal.

(2) Për përbërjen dhe kompetencën e këshillave zgjedhor gjatë zbatimit të referendumit në nivel lokal, në mënyrë përkatëse zbatohen dispozitat e neneve 34 dhe 35 të këtij ligji.

### III. ZBATIMI I REFERENDUMIT

## Neni 45

(1) Gjatë zbatimit të referendumit në nivel shtetëror, zbatohen dispozitat e Ligjit për zgjedhjen e deputetëve në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë, nëse me këtë ligj nuk është përcaktuar ndryshe.

(2) Gjatë zbatimit të referendumit në nivel lokal zbatohen dispozitat e Ligjit për zgjedhjet lokale, nëse me këtë ligj nuk është përcaktuar ndryshe.

### IV. VERIFIKIMI I REZULTATEVE TË REFERENDUMIT

## Neni 46

Këshilli Zgjedhor pas mbarimit të votimit, menjëherë i gaset verifikimit dhe grumbullimit të rezultateve të votimit në vendvotimet.

## Neni 47

(1) Këshilli zgjedhor për votimin e referendumit përpilon procesverbal.

(2) Në procesverbalin për votimin e referendumit futen të dhënat për:

- numrin e vendvotimit;
- përbërjen e këshillit zgjedhor;
- numrin e përgjithshëm të qytetarëve të regjistruar në ekstraktin e Listës zgjedhore;
- numrin e përgjithshëm të qytetarëve që kanë votuar;
- numrin e përgjithshëm të fletave të papërdorura votuese;
- numrin e përgjithshëm të fletave të vlefshme votuese;
- numrin e përgjithshëm të fletave të pavlefshme votuese;
- numrin e përgjithshëm të votave "PËR";
- numrin e përgjithshëm të votave "KUNDËR"; dhe
- numrin e përgjithshëm të votave për çdo propozim kur votohet për më shumë propozime.

(3) Në procesverbal futen edhe vërejtjet e dhëna të anëtarëve të këshillit zgjedhor.

## Neni 48

(1) Procesverbalin e votimit e nënshkruajnë kryetari dhe anëtarët e këshillit zgjedhor.

(2) Procesverbalin i votimit është i vlefshëm nëse është nënshkruar nga shumica e anëtarëve të këshillit zgjedhor.

(3) Kryetari i këshillit zgjedhor duhet t'i shënojë shkaqet për mosnënshtrimin e procesverbalit nga anëtari i këshillit.

(4) Nëse procesverbalin nuk është nënshkruar nga shumica e anëtarëve të këshillit zgjedhor, procesverbalin e përpilon dhe nënshkruan komisioni zgjedhor komunal në bazë të materialit të përgjithshëm votues.

## Neni 49

Procesverbalin dhe materialin e përgjithshëm votues, këshilli zgjedhor në afat prej tri orësh pas mbarimit të votimit, ia dorëzon komisionit zgjedhor komunal.

## Neni 50

Komisioni zgjedhor komunal, pas pranimit të procesverbaleve dhe materialit të përgjithshëm votues nga këshillat zgjedhore, e grumbullon rezultatin e votimit të vendotimeve të rajonit të vet.

## Neni 51

(1) Komisionet zgjedhore komunale për zbatimin e referendimit përpilojnë procesverbal.

(2) Në procesverbalin për zbatimin e referendimit, shënohen të dhënat për:

- numrat e vendeve zgjedhore të rajonit të tyre;
- përbërjen e komisioneve zgjedhore komunale;
- numrin e përgjithshëm të qytetarëve të regjistruar në ekstraktin e Listës zgjedhore për vendet zgjedhore;
- numrin e përgjithshëm të qytetarëve që kanë votuar;
- numrin e përgjithshëm të fletave të papërdorura votuese;
- numrin e përgjithshëm të fletave të vlefshme votuese;
- numrin e përgjithshëm të fletave të pavlefshme votuese;
- numrin e përgjithshëm të votave "PËR";
- numrin e përgjithshëm të votave "KUNDËR"; dhe
- numrin e përgjithshëm të votave për çdo propozim kur votohet për më shumë propozime.

(3) Në procesverbal shënohen edhe vërejtjet e dhëna nga anëtarët e komisionit zgjedhor komunal.

## Neni 52

(1) Procesverbalin për zbatimin e referendimit e nënshkruajnë kryetari dhe anëtarët e komisionit zgjedhor komunal.

(2) Procesverbali është i vlefshëm nëse është nënshkruar nga shumica e anëtarëve të komisionit zgjedhor.

(3) Kryetari i komisionit zgjedhor komunal duhet t'i shënojë shkaqet për mosnënshtrimin e procesverbalit nga anëtarët e komisionit.

(4) Nëse procesverbali nuk është nënshkruar nga shumica e anëtarëve të komisionit zgjedhor komunal, procesverbalin e përpilon dhe e nënshkruan Komisioni Zgjedhor Shtetëror në bazë të materialit të përgjithshëm votues.

## Neni 53

Procesverbalin dhe materialin e përgjithshëm votues, komisioni zgjedhor komunal në afat prej dymbëdhjetë orësh prej pranimit nga këshillat zgjedhore, ia dorëzon Komisionit Zgjedhor Shtetëror.

## Neni 54

Komisioni Zgjedhor Shtetëror pas pranimit të procesverbaleve dhe materialit të përgjithshëm votues nga komisionet zgjedhore komunale, në afat prej 24 orësh e verifikon dhe e shpall rezultatin e votimit të referendimit në nivel shtetëror.

## Neni 55

(1) Komisioni Zgjedhor Shtetëror për rezultatet e votimit të referendimit në nivel shtetëror përgatit raport.

(2) Raporti për rezultatet e votimit të referendimit përmban të dhëna për:

- numrin e përgjithshëm të qytetarëve të regjistruar në Listën zgjedhore;
- numrin e përgjithshëm të qytetarëve që kanë votuar;
- numrin e përgjithshëm të fletave të papërdorura votuese;

- numrin e përgjithshëm të fletave të pavlefshme votuese;

- numrin e përgjithshëm të fletave të vlefshme votuese;
- numrin e përgjithshëm të votave "PËR";
- numrin e përgjithshëm të votave "KUNDËR"; dhe
- rezultatin e referendimit.

## Neni 56

(1) Komisioni Zgjedhor Shtetëror rezultatin e votimit të referendimit në nivel shtetëror e shpall në "Gazetën zyrtare të Republikës së Maqedonisë" në afat prej 15 ditësh nga dita e mbajtjes së referendimit.

(2) Raportin për rezultatin e votimit të referendimit në nivel shtetëror, Komisioni Zgjedhor Shtetëror ia dorëzon Kuvendit.

## Neni 57

Për verifikimin e rezultateve nga votimi i referendimit në nivel lokal, në mënyrë përkatëse zbatohen dispozitat e këtij ligji që kanë të bëjnë me referendumin në nivel shtetëror.

## Neni 58

Komisioni zgjedhor komunal pas pranimit të procesverbaleve dhe materialit të përgjithshëm votues nga këshillat zgjedhore, në afat prej 24 orësh e verifikon dhe shpall rezultatin e votimit të referendimit në nivel lokal.

## Neni 59

(1) Raportin për rezultatin e votimit të referendimit në nivel lokal, komisioni zgjedhor ia dorëzon këshillin të komunës, Qytetit të Shkupit dhe komunave në Qytetin e Shkupit në afat prej tri ditësh nga dita e mbajtjes së tij.

(2) Komisioni zgjedhor rezultatin e votimit të referendimit në nivel lokal, e shpall në fletoren zyrtare të komunës, Qytetit të Shkupit dhe komunave në Qytetin e Shkupit në afat prej 10 ditësh nga dita e mbajtjes së tij.

## Neni 60

Kuvendi, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Punëve të Brendshme, Enti Shtetëror i Statistikës, Shërbimi për punë të përgjithshme dhe të përbashkëta i Qeverisë së Republikës së Maqedonisë, dhe njësitë e tyre rajonale, si dhe komunat, Qyteti i Shkupit dhe komunat në Qytetin e Shkupit, janë të obliguara që organeve për zbatimin e referendimit t'u sigurojnë kushte teknike dhe kushte të tjera për punë.

## V. MJETET PËR ZBATIMIN E REFERENDIMIT

## Neni 61

(1) Mjetet për zbatimin e referendimit në nivel shtetëror, sigurohen nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë.

(2) Me mjetet për zbatimin e referendimit nga paragrafi (10) i këtij neni, disponon Komisioni Zgjedhor Shtetëror.

## Neni 62

(1) Mjetet për zbatimin e referendimit në nivel lokal, sigurohen nga buxheti i komunës, Qytetit të Shkupit dhe komunave në Qytetin e Shkupit.

(2) Me mjetet për zbatimin e referendimit nga paragrafi (1) i këtij neni, disponon komisioni zgjedhor.

## VI. MBROJTJA E TË DREJTËS VOTUESE GJATË ZBATIMIT TË REFERENDIMIT

## Neni 63

(1) Procedura për mbrojtjen e të drejtës votuese në referendum është urgjente.

(2) Kundërshtimet dhe ankesat për mbrojtjen e të drejtës votuese u dorëzohen organeve kompetente përmes organeve që kanë vepruar në shkallë të parë.

(3) Vendimet e shkallës së dytë të organeve kompetente janë përfundimtare.

### **1. Mbrojtja e të drejtës votuese gjatë zbatimit të referendumit në nivel shtetëror**

Neni 64

(1) Çdo qytetar ka të drejtë të parashtrijë ankesë për shkak të parregullsive në procedurën e votimit, grumbullimit dhe verifikimit të rezultateve të votimit në afat prej 24 orësh nga dita e mbajtjes së referendumit në nivel shtetëror në Komisionin Zgjedhor Shtetëror.

(2) Komisioni Zgjedhor Shtetëror është i obliguar që në afat prej 24 orësh nga pranimi i ankesës, të marrë aktvendim.

(3) Kundër aktvendimit të Komisionit Zgjedhor Shtetëror mund të parashtrijë ankesë në Gjykatën Supreme të Republikës së Maqedonisë, në afat prej 48 orësh nga dita e pranimit të aktvendimit.

(4) Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë është e obliguar të veprojë sipas ankesës në afat prej 48 orësh.

### **2. Mbrojtja e të drejtës së votës gjatë zbatimit të referendumit në nivel lokal**

Neni 65

(1) Çdo qytetar ka të drejtë të parashtrijë ankesë për shkak të parregullsive në procedurën e votimit, grumbullimit dhe verifikimit të rezultateve të votimit në afat prej 24 orësh nga dita e mbajtjes së referendumit në nivel lokal në Komisionin Zgjedhor.

(2) Komisioni Zgjedhor është i obliguar që në afat prej 24 orësh nga pranimi i ankesës të marrë vendim.

(3) Kundër vendimit të Komisionit Zgjedhor mund të parashtrijë ankesë në Gjykatën Themelore kompetenca vendore e së cilës është për rajonin e komunës, përkatësisht Qytetin e Shkupit në afat prej 48 orësh nga dita e pranimit të aktvendimit.

(4) Gjykata Themelore është e obliguar të veprojë sipas ankesës në afat prej 48 orësh.

## **VII. INICIATIVA QYTETARE**

### **1. Iniciativa qytetare në nivel shtetëror**

Neni 66

(1) Iniciativa qytetare në nivel shtetëror ngrihet me propozimin e 100 qytetarëve.

(2) Iniciativa qytetare në nivel shtetëror zbatohet për çështjet nga neni 3 paragrafi (2) i këtij ligji.

(3) Propozimi për ngritjen e iniciativës qytetare në nivel shtetëror duhet të parashtrijë nga propozuesi i autorizuar dhe t'u dedikohet çështjes për të cilën kompetent për vendosje është Kuvendi.

(4) Propozuesi i autorizuar në kuptim të paragrafi (3) të këtij neni është nënshkruesi i parë i propozimit për ngritjen e procedurës së iniciativës qytetare.

Neni 67

(1) Propozimi për ngritjen e iniciativës qytetare në nivel shtetëror, i dorëzohet kryetarit të Kuvendit.

(2) Kur kryetari i Kuvendit verifikon se iniciativa është në pajtim me nenin 66 të këtij ligji, në afat prej 3 ditësh për të do ta lajmërojë propozuesin e autorizuar.

(3) Kryetari i Kuvendit pas marrjes së propozimit për ngritjen e iniciativës qytetare, mund të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Maqedonisë, në afat prej 15

ditësh, që të deklarohet nëse është iniciativa qytetare në pajtim me Kushtetutën dhe ligjin.

(4) Nëse kryetari i Kuvendit merr lajmërim me shkrim nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Maqedonisë në afat prej 15 ditësh, për të do ta lajmërojë propozuesin e autorizuar të iniciativës qytetare.

(5) Kur kryetari i Kuvendit do të verifikojë se iniciativa është e parregullt, çështjen lidhur me iniciativën do ta vë në rend dite në mbledhjen e parë të ardhme të Kuvendit, por jo më vonë se 15 ditë nga dita e verifikimit të parregullsive të iniciativës.

(6) Kuvendi me konkluzion vërteton nëse iniciativa është në rregull.

(7) Kryetari i Kuvendit e lajmëron propozuesin e autorizuar për konkluzionin e Kuvendit në afat prej tri ditësh nga dita e miratimit të tij.

Neni 68

(1) Kur kryetari i Kuvendit vërteton se iniciativa është në rregull, përmes kryetarit të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë e lajmëron organin e Drejtorisë shtetërore kompetente për evidentimin e të drejtës zgjedhore.

(2) Në rastet kur iniciativa është në rregull, afati i procedurës për mbledhjen e nënshkrimeve fillon të rrjedhë pas 20 ditësh nga dita e dërgimit të lajmërimit nga kryetari i Qeverisë së Republikës së Maqedonisë në organin e Drejtorisë shtetërore kompetente për evidentimin e të drejtës zgjedhore.

Neni 69

(1) Propozuesi është i obliguar që iniciativën qytetare në nivel shtetëror, për të cilën është parashtrijë propozimi, ta zbatojë në afat prej tre muajsh nga dita e marrjes së lajmërimit për rregullshmërinë e saj.

(2) Nëse në afatin nga paragrafi (10) i këtij neni nuk zbatohet iniciativa qytetare në nivel shtetëror, për të cilën është parashtrijë propozimi, llogaritet se iniciativa nuk është ngritur.

Neni 70

(1) Nënshkrimet e qytetarëve për iniciativë qytetare në nivel shtetëror jepen në formular para organit të Drejtorisë shtetërore kompetente për evidentimin e të drejtës zgjedhore, në kuadrin e orarit të punës.

(2) Formulari nga paragrafi (1) i këtij neni përmban propozimin për të cilin mbledhen nënshkrimet e qytetarëve dhe të dhënat për numrin rendor, emrin dhe mbiemrin, numrin e vetëm amë të qytetarit dhe hapësirën për nënshkrimin e qytetarëve

(3) Në formular, qytetarët nënshkruhen në mënyrë individuale.

(4) Formularin në të cilin jepen nënshkrimet e qytetarëve, e verifikon me vulë dhe me nënshkrim personi zyrtar para të cilit nënshkruhen ata.

(5) Në komunat dhe në Qytetin e Shkupit në të cilat krahas gjuhës maqedonishte dhe alfabetit të saj cirilik, në përdorim zyrtar është edhe gjuha tjetër zyrtare dhe alfabeti i saj, formulari nga paragrafi (2) i këtij neni botohet në gjuhën maqedonishte dhe në alfabetin e saj cirilik, dhe në gjuhën zyrtare dhe në alfabetin që është në përdorim zyrtar në atë komunë dhe në Qytetin e Shkupit.

Neni 71

(1) Iniciativa qytetare në nivel shtetëror për parashtrimin e propozimit për qasje në ndërrimin e Kushtetutës dhe për shpalljen e referendumit, llogaritet si e ngritur nëse së paku 150.000 qytetarë me nënshkrimet e tyre e kanë përkrahur atë iniciativë.

(2) Iniciativa qytetare për propozimin e nxjerrjes së ligjit llogaritet si e ngritur nëse 10.000 qytetarë me nënshkrimet e tyre e kanë përkrahur atë iniciativë.

## Neni 72

Përfaqësuesi i autorizuar i propozuesit, formularin me nënshkrimet e qytetarëve për propozimin për të cilin është ngritur iniciativa në nivel shtetëror, ia dorëzon kryetarit të Kuvendit në afat prej tri ditësh nga dita e mbarimit me dhënien e nënshkrimeve.

## Neni 73

(1) Kuvendi pa debat merr vendim për iniciativën qytetare nga neni 71 paragrafi (1) i këtij ligji.

(2) Kuvendi për iniciativën nga neni 71 paragrafi (2) është i obliguar të vendosë në afat prej 30 ditësh nga dita e marrjes së propozimit.

(3) Kuvendi për vendimin sipas propozimit nga paragrafi (2) i këtij neni i informon qytetarët.

(4) Informimi i qytetarëve bëhet përmes mjeteve për informim publik.

## 2. Iniciativa qytetare në nivel lokal

## Neni 74

(1) Iniciativa qytetare në nivel lokal ngrihet para këshillit të komunës, Qytetit të Shkupit dhe komunave në Qytetin e Shkupit.

(2) Iniciativa qytetare në nivel lokal zbatohet përmes dhënies së nënshkrimeve të qytetarëve për çështjet nga neni 3 paragrafi (3) i këtij ligji.

(3) Iniciativa qytetare në nivel lokal nuk mund të ngrihet për çështje financiare dhe kadrovike.

## Neni 75

(1) Iniciativa qytetare në nivel lokal ngrihet me propozimin e 100 qytetarëve.

(2) Propozimi për ngritjen e iniciativës qytetare në nivel lokal i dorëzohet kryetarit të këshillit.

(3) Propozimi për ngritjen e iniciativës qytetare në nivel lokal duhet të parashtrohet nga propozuesi i autorizuar dhe t'i dedikohet çështjes për të cilën kompetent për vendosje është këshilli i komunës, të Qytetit të Shkupit dhe komunave në Qytetin e Shkupit.

(4) Propozues i autorizuar në kuptim të paragrafit (3) të këtij neni, është nënshkruesi i parë i propozimit për ngritjen e iniciativës qytetare.

## Neni 76

(1) Kryetari i këshillit pas marrjes së propozimit për iniciativë qytetare në afat prej ditësh do të ekzaminojë nëse është parashtruar propozimi nga propozuesi i autorizuar dhe nëse u dedikohet çështjeve për të cilat për vendosje është kompetent këshilli.

(2) Kur kryetari i këshillit do të vërtetojë se iniciativa është në pajtim me nenin 75 paragrafin (3) të këtij ligji, në afat prej tri ditësh për të do ta lajmërojë propozuesin e autorizuar.

(3) Kur kryetari i këshillit do të vërtetojë se iniciativa është e parregullt, çështjen lidhur me iniciativën do ta vë në rend dite në mbledhjen e parë të ardhme të këshillit, por jo më vonë se 15 ditë nga dita e vërtetimit të parregullsisë së iniciativës.

(4) Kuvendi me konkluzion vërteton nëse është në rregull iniciativa.

(5) Kryetari i këshillit e lajmëron propozuesin e autorizuar për konkluzionin e këshillit në afat prej tri ditësh nga dita e miratimit të tij.

## Neni 77

(1) Propozuesi është i obliguar që iniciativën qytetare në nivel lokal për të cilën është parashtruar propozimi, ta zbatojë në afat prej një muaji nga dita e marrjes së lajmërimit për rregullshmërinë e saj.

(2) Nëse në afatin nga paragrafit (1) i këtij neni nuk zbatohet iniciativa qytetare në nivel lokal për të cilin është parashtruar propozimi, llogaritet se iniciativa nuk është ngritur.

## Neni 78

Nënshkrimet e qytetarëve për iniciativën qytetare në nivel lokal jepen para organit të Drejtorisë shtetërore kompetente për evidentimin e të drejtës zgjedhore dhe në mënyrë të përcaktuar me nenin 70 të këtij ligji.

## Neni 79

Iniciativa qytetare në nivel lokal llogaritet si e ngritur nëse së paku 10% e qytetarëve të regjistruar në ekstraktin e Listës zgjedhore për komunën, Qytetin e Shkupit dhe komunat në Qytetin e Shkupit me nënshkrimet e tyre e kanë përkrahur iniciativën.

## Neni 80

Përfaqësuesi i autorizuar i propozuesit, formularin me nënshkrimet e qytetarëve për propozimin për të cilin është ngritur iniciativa në nivel lokal, ia dorëzon kryetarit të këshillit në afat prej tri ditësh nga dita e mbarimit të dhënies së nënshkrimeve.

## Neni 81

(1) Kuvendi është i obliguar të vendosë në afat prej 30 ditësh pas pranimit të propozimit.

(2) Kuvendi për vendimin lidhur me propozimin i informon qytetarët.

(3) Informimi i qytetarëve bëhet përmes mjeteve për informim publik në mënyrë të përcaktuar me statutin.

## VIII. TUBIMI I QYTETARËVE NË KOMUNË

## Neni 82

(1) Tubimi i qytetarëve konvokohet për shkak të deklarimit të qytetarëve për çështje të veçanta me rëndësi për vetadministrimit vendor dhe për shkak të ngritjes së iniciativës për zgjidhjen e çështjeve me rëndësi lokale.

(2) Në tubimin e qytetarëve, qytetarët shqyrtojnë çështje, marrin qëndrime dhe përgatisin propozime për çështje me rëndësi të drejtpërdrejtë dhe të përditshme për jetën dhe punën e qytetarëve nga rajoni i komunës, përkatësisht vetadministrimit vendor.

## Neni 83

Në tubimin e qytetarëve të drejtë për vendosje kanë qytetarët me vendbanim në rajonin në të cilin është organizuar tubimi.

## Neni 84

(1) Tubimi i qytetarëve mund të konvokohet për rajonin e mbarë komunës apo për rajonin e vetadministrimit vendor për të cilin i dedikohet çështja.

(2) Tubimin e qytetarëve e konvokon prefekti i komunës, i Qytetit të Shkupit dhe i komunave në Qytetin e Shkupit (në tekstin e mëtejshëm: prefekti) me iniciativën personale, me kërkesën e këshillit apo me kërkesën e së paku 10 % të qytetarëve të regjistruar në ekstraktin e Listës zgjedhore për komunën, Qytetin e Shkupit dhe komunat në Qytetin e Shkupit, përkatësisht vetadministrimit vendor për të cilin është konvokuar tubimi.

## Neni 85

(1) Kërkesa për konvokimin e tubimit të qytetarëve përmban nënshkrimet e qytetarëve të cilët janë të regjistruar në ekstraktin e Listës zgjedhore për rajonin për të cilin konvokohet tubimi.

(2) Kërkesa për konvokimin e tubimit të qytetarëve i dërgohet prefektit.

(3) Prefekti është i obliguar që në afat prej 30 ditësh pas pranimit të kërkesës, ta konvokojë tubimin e qytetarëve.

Neni 86

(1) Për konvokimin e tubimit të qytetarëve prefekti merr vendim.

(2) Informimi i qytetarëve për tubimin e qytetarëve bëhet përmes mjeteve për informim publik në mënyrë të përcaktuar me statutin e komunës, Qytetit të Shkupit dhe komunave në Qytetin e Shkupit.

Neni 87

(1) Në tubimin e qytetarëve vendosin qytetarët me të drejtë zgjedhore.

(2) Tubimin e qytetarëve e udhëheq prefekti apo personi nga administrata komunale, përkatësisht nga administrata e Qytetit të Shkupit që ai do ta autorizojë.

(3) Për çështjen për të cilën debatohet në tubimin e qytetarëve informon prefekti, dhe sipas nevojës edhe përfaqësuesit e administratës komunale dhe administratës së Qytetit të Shkupit.

(4) Me statutin e komunës, Qytetit të Shkupit dhe komunave në Qytetin e Shkupit në mënyrë më të përafërt rregullohet mbajtja e tubimit të qytetarëve.

Neni 88

(1) Tubimi i qytetarëve mund të miratojë konkluzione për punën e organeve të komunës, Qytetit të Shkupit dhe komunave në Qytetin e Shkupit.

(2) Tubimi i qytetarëve konkluzionet i miraton me shumicë votash nga qytetarët e pranishëm në tubim.

Neni 89

Organet e komunës, Qytetit të Shkupit dhe komunave në Qytetin e Shkupit, janë të obliguara që në afat prej 90 ditësh nga dita e mbajtjes së tubimit, konkluzionet t'i shqyrtojnë dhe për vendimet e tyre t'i informojnë qytetarët përmes mjeteve për informim publik në mënyrë të përcaktuar me statutin e komunës, Qytetit të Shkupit dhe komunave në Qytetin e Shkupit.

## IX. DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 90

Procedurat për referendum dhe format tjera të deklarimit të drejtpërdrejtë, të cilat kanë filluar dhe të cilat në ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji nuk kanë mbaruar, do të mbarojnë sipas dispozitave të këtij ligji.

Neni 91

Komunat, Qyteti i Shkupit dhe komunat në Qytetin e Shkupit, do t'i harmonizojnë dispozitat e statuteve të komunave, Qytetit të Shkupit dhe komunave në Qytetin e Shkupit me dispozitat e këtij ligji në afat prej tre muajsh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 92

Me ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, ndërpritet të vlejë Ligji për parimet e përgjithshme të referendumit dhe për format tjera të vendosjes me deklaram individual ("Gazeta zyrtare e RSM-së" nr. 19/79), Ligji për procedurën e mbledhjes së nënshkrimeve të zgjedhësve për propozimin e nxjerrjes së ligjit, për shpalljen e referendumit dhe për paraqitjen e propozimit për qasje në ndryshimin e Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë (Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 16/96) dhe Ligji për referendum dhe iniciativë qytetare ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë", nr. 24/98).

Neni 93

Ky ligj hyn në fuqi ditën e tetë nga dita e shpalljes në "Gazetën zyrtare të Republikës së Maqedonisë".

1086.

Vrz основа на член 75 ставови 1 и 2 од Уставот на Република Македонија, претседателот на Република Македонија и претседателот на Собранието на Република Македонија издаваат

### У К А З

#### ЗА ПРОГЛАСУВАЊЕ НА ЗАКОНОТ ЗА ИЗМЕНУВАЊЕ И ДОПОЛНУВАЊЕ НА ЗАКОНОТ ЗА ЖИВОТНАТА СРЕДИНА

Се прогласува Законот за изменување и дополнување на Законот за животната средина, што Собранието на Република Македонија го донесе на седницата одржана на 16 септември 2005 година.

Бр. 07-3382/1  
16 септември 2005 година  
Скопје

Претседател  
на Република Македонија,  
**Бранко Црвенковски, с.р.**

Претседател  
на Собранието на Република  
Македонија,  
д-р **Љупчо Јордановски, с.р.**

### ЗАКОН

#### ЗА ИЗМЕНУВАЊЕ И ДОПОЛНУВАЊЕ НА ЗАКОНОТ ЗА ЖИВОТНАТА СРЕДИНА

Член 1

Во Законот за животната средина ("Службен весник на Република Македонија" број 53/2005) во членот 162 ставот (4) се менува и гласи:

"(4) Средствата од членовите 179, 181, 182, 183, 184 и 185 на овој закон, се приход на Буџетот на Република Македонија и се уплаќаат на соодветна уплатна сметка, во рамките на трезорската сметка."

По ставот (4) се додава нов став (5), кој гласи:

"(5) Средствата од членот 180 на овој закон се приход на органот на државната управа надлежен за работите од областа на животната средина и се уплаќаат на соодветна уплатна сметка, во рамките на трезорската сметка."

Член 2

Овој закон влегува во сила осмиот ден од денот на објавувањето во "Службен весник на Република Македонија".

### L I G J I

#### PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT PËR MJEDISIN JETËSOR

Neni 1

Нë Ligjin për mjedisin jetësor ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 53/2005) në nenin 162 paragrafi (4) ndryshon si vijon:

"(4) Mjetet nga nenet 179, 181, 182, 183, 184 dhe 185 të këtij ligji, janë hyrje të Buxhetit të Maqedonisë dhe paguhen në llogari përkatëse të pagesës, në kuadër të llogarisë së trezorit."

Pas paragrafit (4) shtohet paragraf i ri (5) si vijon:

"(5) Mjetet nga neni 180 të këtij ligji janë hyrje të organit të administratës shtetërore për punët nga sfera e mjedisit jetësor dhe paguhen në llogari të pagesës përkatëse, në kuadër të llogarisë së trezorit."

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi ditën e tetë nga dita e shpalljes në "Gazetën zyrtare të Republikës së Maqedonisë".

## ЈП СЛУЖБЕН ВЕСНИК НА РМ ВИ НУДИ

Р.бр	Издавање	Цена	Р.бр	Издавање	Цена
1	Збирки на прописи од областа на локалната самоуправа, 2004		7	Закон за опшната управна постапка (со коментар)	
а)	I книга – (Законите за: локална самоуправа; територијална организација на локалната самоуправа; за градот Скопје; финансирањето на единиците на локалната самоуправа и Законот за локалните кадри – редакциски пречистен текст)	900.00	8	Закон за работните односи (редациска збирка, 2005)	660.00
б)	II книга – (Законите за: колективните договори; медијација; уредителска дејност; пристанишна дејност и Законот за одржење значајна дејност)	600.00	9	Закон за извршната постапка	300.00
в)	III книга – (Редациски пречистени текстови на Законите за: основното образование; средното образование; заштите на децата и Законот за социјална заштита)	700.00	10	Закон за прекршоците (со објаснувања, коментари, судска практика, со прилоги)	350.00
г)	IV книга – (Закон за управување со отпадот; Закон за квалитетот на животната средина; Законите за заштите на природата)	500.00	11	Закон за спречување на корупцијата (со Законот за ратификација на конвенцијата)	250.00
а)	Комплет од четирите книги - Збирки на Законите од областа на локалната самоуправа, 2004, по цена од	2100.00	12	Закон за денационализација (со коментар, објаснувања и обрасци)	250.00
2	Збирка на прописи (редациска) (Законите за: градење; за просторно и урбанистичко планирање; за животната средина)	700.00	13	Збирка на прописи од областа на државјанството	200.00
3	Закон за трговските друштва, со вовед, 2004	800.00	14	Устав на Република Македонија (со сите амандман и рамковен договор) на македонски јазик (мек. повез) на англиски јазик (мек. повез)	300.00 400.00
4	Закон за јавните набавки, 2004 (со подзаконските акти)	200.00	15	Комплет CD-ROM изданија 2001, 2002, 2003 и 2004 година	5200.00
5	Закон за кривична постапка и Закон за извршување на санкциите (редациски пречистени текстови)	900.00	16	Поединечни CD-ROM изданија 2001, 2002, 2003 и 2004 година	1500.00
6	Збирка на меѓународни конвенции од областа на кривичното право, 2000	150.00	17	Регистар на прописи на РМ	3700.00
			18	WEB - базата на прописи од 1945 до денес. www.slvesnik.com.mk	

-----

### П О Р А Ч К А бр. 81

Со ова неотповикливо ги порачуваме изданијата под реден број \_\_\_\_\_ во \_\_\_\_\_ примероци;  
 р.бр. \_\_\_\_\_ во \_\_\_\_\_ примероци; р.бр. \_\_\_\_\_ во \_\_\_\_\_ примероци; р.бр. \_\_\_\_\_ во \_\_\_\_\_ примероци;  
 р.бр. \_\_\_\_\_ во \_\_\_\_\_ примероци; р.бр. \_\_\_\_\_ во \_\_\_\_\_ примероци; р.бр. \_\_\_\_\_ во \_\_\_\_\_ примероци.

Доказот за извршена уплата на жиро с-ка 300000000188798 и порачката ги испраќаме по пошта на адреса бул. „Партизански одреди“ бр. 29, п. факс 51, 1000, Скопје, или на телефакс број + 389-2-311-22-67,

Порачател: \_\_\_\_\_

Место: \_\_\_\_\_, ул. \_\_\_\_\_, бр. \_\_\_\_\_, тел./факс \_\_\_\_\_

Потпис на порачателот

Во \_\_\_\_\_, \_\_\_\_\_ 2005 година. (М.П.) \_\_\_\_\_



www.slvesnik.com.mk  
 contact@slvesnik.com.mk

Издавач: ЈП СЛУЖБЕН ВЕСНИК НА РЕПУБЛИКА МАКЕДОНИЈА, ц.о.-Скопје  
 бул. "Партизански одреди" бр. 29. Поштенски факс 51.  
 Директор и одговорен уредник - Борис Тренески.  
 Telefони: +389-2-3298-860.  
 Телефакс: +389-2-3112-267.

Претплатата за 2005 година изнесува 9.200,00 денари.  
 „Службен весник на Република Македонија“ излегува по потреба.  
 Рок за рекламации 15 дена.  
 Жиро-сметка: 300000000188798. Број за ДДВ МК: 4030987108771.  
 Депонент: Комерцијална банка, АД - Скопје.  
 Печат: Графички центар КМ Креатив - Скопје.